



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Infermieri”

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Evis Allushi

Dr. Julian Kraja

Nëntor / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në: “Infermieri”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Infermieri”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1184, datë 03.12.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr.297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022 - 2023 27 PAE / 7 PAK; Viti akademik 2023 - 2024 26 PAE / 8 PAK;
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023 105 studentë; Viti akademik 2023 - 2024 117 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë u krijua në vitin 2013, si universiteti i parë gjithëpërfshirës i arsimit të lartë publik në shkencat mjekësore dhe i kërkimit shkencor në vend, pas një tradite 65 vjeçare të formimit universitar publik në fushën e shkencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë, pas krijimit të Institutit të Lartë Mjekësor në vitin 1952 dhe Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1957. Ky institucion është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr. 03, datë 27.01.2023 maksimalisht me 6 vite me afat vlefshmërie deri në 26/01/2029. Në vitin 2016, UMT u riorganizua dhe tashmë përbëhet nga tri fakultete:

1. Fakulteti i Mjekësisë;
2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
3. Fakulteti i Mjekësisë Dentare;

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ku ofrohet dhe programi i studimit Master i Shkencave në "Infermieri", ka në përbërjen e vet:

1. Departamenti i Lëndëve Klinike, Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri (DLKIPISBP);
2. Departamentin e Lëndëve Paraklinike (DLP);
3. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji (DDRSHIKIOGJ);

Programi i studimit Master i Shkencave në "Infermieri" ofrohet nga tre njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Këto tre Njësi bazë ofronjë po ashtu programe studimi:

- Bachelor në Infermieri e Përgjithshme, në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laborator dhe në Logopedi;
- Master Profesional në Menaxhim infermior, në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laborator, në Logopedi, në Kujde Paliativ dhe në Infermieri Familje;
- Master i Shkencave në Teknikë imazherie, në Mami, në Fizioterapi, në Teknikë laborator dhe në Logopedi;
- Doktoraturë në "Shkenca Mjekësore Teknike" me nënfusha (Fizioterapi dhe Rehabilitim; Infermieri dhe Mami; eknologji mjekësore diagnostikuese dhe trajtuese)

Departamenti funksionon si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore, për programet respektive të studimit që ofron. Vizioni i FSHMT është të vazhdojë të jetë lider në drejtimin dhe transformimin e shkencës së infermierisë në Shqipëri, si dhe mënyrën se si mësohet dhe praktikohet infermieristika. Programi i studimit Master i Shkencave në "Infermieri" ofrohet që prej vitit 2009 bazuar në VKM Nr. 1184, datë 03.12.2009.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Infermieri” që ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (UMT), filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UMT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 18-19 mars 2024. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga një specialist i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm kishte në përbërje **Dr. Julian Kraja** dhe **Dr. Evis Allushi**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL u zhvilluan takimet me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe të Njesisë Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Paralelisht, u zhvilluan dhe takime me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, me përfaqësues të Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentit, me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve akademike, me përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumnit dhe me sekretarinë mësimore.

Paralelisht, u zhvillua vizita në ambientet e Fakultetit. Gjatë vizitës në Institucion u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara.

Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatoren Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Nga hartimi i RVB dhe dokumentacioni i dorëzuar, GVJ konstaton se:

- Në disa raste nuk jepeshin evidenca për ato që raportoheshin;
- Rregullorja e programit mësimor nuk është orientuese;
- Rregullore e Departamentit ishte inekzistente;



Universiteti i Mjekësisë, Tiranë". është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.09.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 86/29 Prot, datë 23.09.2024. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë", njofton më datë 17.10.2024, nëpërmjet shkresës me nr. 315/24, prot, datë 15.10.2024," *Kthim përgjigje shkresës suaj Nr. 86/29 Prot, datë 23.09.2024". Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

1. Lidhur me komentin për **Standardin II. 1. Kriteri 1**, çdo konstatim që është bërë nga ana e GVJ është bazuar dhe interpretuar sipas VKM nr 41, 2018. GVJ ka rekomanduar rregullimin e planit mësimor në përputhshmëri me VKM nr 41. Ashtu siç thuhet dhe tek komenti UMT që kanë ngritur grupin e punës për rregullim e planit mësimor dhe GVJ këtë ka kërkuar, që të rregullohet, prandaj për sa më sipër **nuk ka ndryshime në raport.**
2. Lidhur me komentin për **Standardin II. 3. Kriteri 1**, lidhur me rregulloren, çdo konstatim që është bërë nga ana e GVJ është bazuar mbi dokumentacionin e sjellë nga UMT. Ashtu siç shprehet dhe UMT në komentet e sjella që rregullorja do të ndryshohet, ky është dhe rekomandimi i GVJ, prandaj për sa më sipër **nuk ka ndryshime në raport.**
3. Lidhur me komentin për **Standardin II. 3. Kriteri 2**, sygjeron rritjen e orëve të praktikës, por që nuk është domosdoshmëri dhe nuk ndikon në vlerësimin e performancës, ndërsa përlllogaritja e orëve duhet të bëhet me korrektësi të madhe, prandaj për sa më sipër **nuk ka ndryshime në raport.**
4. Lidhur me komentin për **Standardin II. 3. Kriteri 4**, për sa i përket syllabuseve, kjo çështje u diskutua edhe gjatë vizitës në institucion, në takimin me drejtuesit dhe me stafin akademik, ku pothuajse të gjitha syllabuset ishin të papërditësuara dhe se ato ishin të njëjta për të tre vitet akademike, dhe u pranua nga ana e tyre se ato kishin nevojë për përditësim, për sa më sipër **nuk ka ndryshime në raport.**
5. Lidhur me komentin për **Standardin II. 4. Kriteri 5**, për sa i përket syllabuseve, është e vërtetë se UMT ka kaluar akreditimin institucional, por kjo nuk do të thotë se syllabuset janë të përditësuara, gjë që dhe vetë FSHMT shprehet se do i përditësojmë, prandaj për sa më sipër **nuk ka ndryshime në raport.**
6. Lidhur me komentin për **Standardin II. 4. Kriteri 4**, për sa i përket mobilitetit të studentëve, GVJ mer parasysh komentin e institucionit, ndaj **raporti ndryshon, por nuk ndryshon gjë në vlerësimin përfundimtar.**
7. Lidhur me komentin për **Standardin IV. 1. Kriteri 2**, mbi mbulimin e ngarkesës mësimore nga stafi akademik efektiv jo më pak se 70 %, GVJ ka shqyrtuar dokumentacionin e sjellë nga FSHM, ku është konstatuar se stafi akademik efektiv nuk mbulon me më pak se 70%, të ngarkesës

mësimore të programit të studimit, sipas VKM nr. 418, datë 10.05.2017, ndaj **nuk ka ndryshime në raport.**

8. Lidhur me komentin për **Standardin IV. 1, Kriteri 4**, GVJ ka rekomanduar që CV të jenë që azhornuara dhe të standarizuara, gjë e cila duhet të marret në konsideratë nga UMT, ku vetë UMT shprehet se e ka marrë në konsideratë, ndaj **nuk ka ndryshime në raport.**
9. Lidhur me komentin për **Standarti V.5 kriteri 3**, për pjesëmarrjen e studenteve në plotësimin e pyetësorëve, GVJ ka rekomanduar që stafi të përfshihet më shumë në këtë proces duke bërë të mundur përfshirjen e studentëve në plotësimin e pyetësorëve, dhe GVJ mendon se kjo është një gjë e drejtë, ndaj **nuk ka ndryshime në raport.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Infermieri”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë (UMT) nuk bien ndesh me interesat kombëtare. UMT vepron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. Misioni i UMT (Statuti i UMT, neni 4) synon arsimimin e lartë gjithëpërfshirës të studentëve vendas e të huaj, studimet dhe kualifikimet e mëtejshme në fushën e mjekësisë dhe ka për qëllim zhvillimin e arsimit, edukimit dhe kërkimit shkencor në fushën e mjekësisë. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UMT;</i>

Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” është hartuar dhe ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. UMT ka si mision të ofrojë shërbime në përputhje me misionin e vet si dhe të ofrojë programe studimi në të tre ciklet e studimit. Një nga objektivat kryesor të UMT është mësimdhënia, kurrikulat dhe mësimnxënia me në qendër formimin e studentëve. Kjo arrihet përmes formimit të specialistëve në fushën e shëndetësisë. Ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin, qëllimet dhe strategjinë e Institucionit. Kjo pikë përmendet edhe në Rregulloren e programit të studimit (neni 3). Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UMT;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Infermieri”;</i> <i>Evidenca 170 Plani Strategjik i zhvillimit të UMT 2021-2024.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Strategjia e UMT ka disa objektiva specifike të cilat fokusohen tek organizimi institucional, mësimdhënia, kërkimi shkencor, sigurimi i brendshëm i cilësisë, veprimtaritë shërbyese si dhe marrëdhëniet me jashtë/ndërkombëtarizimi. Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” ofrohet në përputhje me këtë strategji. Zgjerimi i infrastrukturës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) shtesë vertikale. <i>Nuk ka një raportim specifik mbi këtë program studimi në Plan Strategjinë e UMT.</i> Programi i studimit ofrohet në përputhje me Rregulloren e UMT (Neni 3) si dhe Rregulloren e Njësisë Kryesore (Neni 6). Sigurimi i cilësisë është një nga pikat kryesore të strategjisë së Institucionit dhe për këtë arsye, programi i studimit është akredituar edhe në të kaluarën. Evidenca: <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Infermieri”;</i>

	<i>Evidenca 170 Plani Strategjik i zhvillimit të UMT 2021-2024.</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare. Programi është në përputhje me vizionin, si edhe në vijim të arritjes të objektivave strategjike të këtij programi studimi. Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe ofrohet në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare. Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale dhe shkencore të të diplomuarve në nivelin bachelor dhe që duan të vazhdojnë më tej karrierën profesionale në shkencat infermiere. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UAM;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 170 Plani Strategjik i zhvillimit të UMT 2021-2024.</i>			
Konkluzione	Programi i studimit që ofrohet nga UMT nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Programi i studimit Master i Shkencave në "Infermieri" është hartuar dhe ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. UMT ka si mision të ofrojë shërbime në përputhje me misionin e vet si dhe të ofroj programe studimi në të tre ciklet e studimit. Programi i studimit Master i Shkencave në "Infermieri" ofrohet në përputhje me strategjinë e UMT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e	UMT u krijua në vitin 2013, si universiteti i parë gjithëpërfshirës i arsimit të lartë publik në shkencat mjekësore dhe i kërkimit shkencor në vend, pas një tradite 65 vjeçare të formimit

duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

universitar publik në fushën e shkencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë, pas krijimit të Institutit të Lartë Mjekësor në vitin 1952 dhe Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1957.

Godina në të cilën ofrohet ky program studimi është e përshtatshme dhe gjendet në ambejtet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT). Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” ofrohet që prej vitit 2009 bazuar në VKM Nr. 1184, datë 03.12.2009.

Stafi akademik në FSHMT për vitin akademik 2022 – 2023 është 63 PAE dhe 242 PAK me kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi	PAE	PAK
Prof. Dr.	6	1
Prof. Asoc.	17	6
Dr./PhD	35	39
Msc.	5	196
Total	63	242

Fakulteti rezulton të ketë akses të veçantë dhe të drejtpërdrejtë në QSUT dhe spitalet e tjera universitare në vend nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave sipas të cilit ato konsiderohen pjesë integrale e UMT. Nga sa më sipër, GVJ gjykon se fakulteti ka kapacitetet e nevojshme dhe stafin e kualifikuar për të ofruar me cilësi programin e studimit Msc Infermieri. Laboratorët e Departamentit janë të disponueshëm për realizimin e këtij programi studimi. Laboratorët e Departamentit janë të disponueshëm për realizimin e këtij programi studimi.

Evidenca:

Evidenca 8 Historiku i FSHMT

Evidenca 77 Vendimi për Akreditimin Inst. të UMT

Evidenca 25 Vendimi për licesnimin e programit msc infermieri

RVB- MSH në Infermieri;

Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor i DLKIPISBP

Evidenca 80; 81; 82 Raporti vjetor i FSHMT



	<i>Evidenca 97 Tabela përmbledhëse</i> <i>Evidenca 117 Laboratori i infermieristikes</i> <i>Evidenca 118 Infrastruktura ne funksion te mesimdhenies</i> <i>Evidenca 119. Lista e asetëve infrastrukturore te UMT</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë;</i> <i>Vizita në ambientet e FSHMT.</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njësive Bazë. Programet e studimit në UMT, synojnë transmetimin e njohurive në shërbim të vendit dhe shoqërisë. Programet synojnë edukimin dhe kualifikimin shkencor e profesional të studentëve në fushën e mjekësisë. GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri" është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UAM;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP</i> <i>Evidenca 55 Lista e programeve të studimit të ofruara në UMT</i> <i>Evidenca 169 RVB Institucional _UMT</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Ky program studimi është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Njësive Bazë. Ky nuk është një program ndërdisiplinor. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UAM;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Infermieri”;</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një	Nuk ka aplikim për këtë program studimi.

drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në përfundim të këtij programi studimi, studentët e diplomuar kanë mundësi për studime të mëtjshme pranë UMT pasi Institucioni ofron Cikël të tretë të studimeve “Doktoraturë” në fushën e Infermierisë. Me qëllim trajnimit të mëtjshëm, UMT mundohet të organizoj trajnime profesionale, përfshirë këtu workshope, leksione të hapura, seminare apo trajnime. <i>Nuk u raportuan trajnime profesionale specifike me punëdhënësit.</i> Evidenca: <i>Evidenca 55 Lista e programeve të studimit të ofruara në UMT</i> <i>Evidenca 15 Aktivitete studentesh konfere e shkencave mjekësore</i> <i>Evidenca 18. Konferenca vjetore FSHMT</i> <i>Evidenca 18.1 Konferenca Vjetore DLKIPISBP Dhjetor 2022</i> <i>Evidenca 29. Konferenca në Vlorë</i> <i>Evidenca 30. Konferenca-vjetore 2023 FSHMT- UISH</i> <i>Evidenca 108 Aktivitete të Zyres së Karrierës FSHMT</i> <i>Evidenca 124 Aktivitetet e këshillit studentor</i>			
Konkluzione	<i>UMT u krijua në vitin 2013, si universiteti i parë gjithëpërfshirës i arsimit të lartë publik në shkencat mjekësore dhe i kërkimit shkencor në vend, pas një tradite 65 vjeçare të formimit universitar publik në fushën e shkencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë, pas krijimit të Institutit të Lartë Mjekësor në vitin 1952 dhe Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1957.</i> <i>GVJ gjen një përputhje të plotë mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UMT ka në Rregulloren dhe Statutin e vet njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarëvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara detyrat dhe rolin e vet. Me qëllim ofrimin e këtij programi studimi, Njësitë bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Kjo u raportua dhe në takimet e zhvilluara në Institucion. Rregullorja e Njesisë Kryesore përcakton rolet e të gjitha njësive në nivel Fakulteti. Në rregulloren e Njesisë Bazë përcaktohen rolet dhe detyrat në nivel departamenti. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UMT;</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 172 Rregullore e funksionimit Këshillit të Etikës UMT</i> <i>Evidenca 173 Rregullore për përdorimin e postës elektronike</i> <i>Evidenca 174 Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në UMT</i> <i>Evidenca 175 Rregullore për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e Konfidencialitetit në UMT</i> <i>Evidenca 176 Rregullore për fitimin e titujve akademike UMT</i> <i>Evidenca 179 Rregullore për hartimin, zbatimin, menaxhimin e Projekteve UMT</i> <i>Evidenca 180 Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni	Me qëllim formimin e studentëve, Qendrat Spitalore Universitare janë në dispozicion të studentëve të UMT, ku ata formohen sidomos në funksion të praktikës profesionale. Në takimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë, u

vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	informuam se janë 85 mbikqyrës së praktikës profesionale që ndjekin studentët në terren. Gjithashtu UMT raporton 10 marrëveshje bashkëpunimi Erasmus me Institucione jashtë Shqipërisë. Evidenca: <i>Evidenca 144 VKM Për miratimin e strukturave shëndetësore universitare;</i> <i>Evidenca 49 Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera;</i> <i>Evidenca 44 Lista e projekteve nderkombetare te aplikuar dhe te fituara:</i> <i>Evidenca 44.1 Projekte nderkombetare te fituara</i> <i>Evidenca 39.1 Pjesmarrje stafi ne aktivitete Ersamus</i> <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor i DLKIPISBP;</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raporti vjetor i FSHMT</i> <i>Evidenca 79; 70.1 Raport Vjetor Institucional;</i> <i>Evidenca 97 Tabela përmbledhëse</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet në ambjentet e Qendrave Spitalore Universitare të rregulluara me VKM. UMT ofron mundësitë më të mira për zhvillimin e praktikave profesionale. Gjithashtu ka dhe marrëveshje të shumta me shumë kompani, organizata dhe universitete të tjera. Evidenca: <i>Evidenca 144 VKM Për miratimin e strukturave shëndetësore universitare;</i> <i>Evidenca 49 Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera;</i> <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor i DLKIPISBP;</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raporti vjetor i FSHMT</i> <i>Evidenca 79; 70.1 Raport Vjetor Institucional;</i> <i>Evidenca 13.1; 13.2; 13.3 Ditar i praktike</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e	Departamenti ka hartuar një raport mbi përfitimet nga marrëveshjet egzistuese. Ajo përmban institucionin që është

studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	nënshkruar marrëveshja, qëllimin, përfitimet, data e nënshkrimit si dhe afati i marrëveshjes. Evidenca: <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor i DLKIPISBP;</i>			
Konkluzione	<i>UMT ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara detyrat dhe rolin e vet. Me qëllim formimin e studentëve, UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të	Nenit 70, pika 2 e Rregullores së UMT, programet e ciklit të dytë (Master i Shkencave) organizohen në programe që realizohen jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike. Neni 74, pika 2 e Rregullores së UMT, veprimtaritë formuese grupohen sipas akteve ligjore përkatëse. Ky është një program studimi me 120 kredite (ECTS), dhe ky program ofrohet në module të veçanta

Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Aktiviteti përfshin në total 3000 orë nga të cilat: 1437 orë në auditor; 1563 jashtë auditorit; Nga plani mësimor lëndët janë ndarë në: Lëndë Bazë 12 kredite, 10%; Lëndë Karakterizuese 61 kredite, 51%; Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese 19 kredite, 16%; Lëndë Plotësuese 12 kredite, 10%; Detyrime Përmbyllëse 16 kredite, 13%; GVJ konstatoi se shpërndarja e veprimtarive formuese në Planin mësimor për programin Master i Shkencave në “Infermieri” (edhe pse shpërndarja në përqindje të veprimtarive formuese është korrekte) bëhet në bazë të moduleve dhe jo lëndëve. <i>Duke qënë se moduli është pjesë integrale e lëndës, nuk mundet që dy module brenda të njëjtës lëndë të jenë me veprimtari formuese të ndryshme. Kjo bie ndesh me VKM 41, 24. 01. 2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”.</i> Evidenca: <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri</i> <i>Evidenca 91.Plani mesimor MSc. Infermieri</i> <i>Evidenca 97 Tabela permbledhese</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës,	Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale dhe shkencore të të diplomuarve në nivelin bachelor dhe që duan të vazhdojnë më tej karrieren profesionale duke u specializuar në fushën e Infermierisë. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike për arsye të karakterit të mirëfilltë profesional të tij dhe



zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	njohurive nga fusha e infermierisë, duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin metejshëm të studentëve për punësim. Programi i studimit në “Master i Shkencave në Infermieri” ka qëllim të pajisë studentët me: • kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional; • njohuri të mira të shërbimit shëndetësor, të higjenës spitalore, trajtimit ambulator dhe hospitalor të pacientëve, përgatitjen operatore dhe ndjekjen post-operatore të tyre, njohjen me aparaturat mjekësore dhe mirëmbajtjen e tyre; ndihmën e parë në urgjencat mjekësore në mjedisin hospitalor dhe jashtë tij; • aftësi në mënyrën e komunikimit midis kolegëve, eprorëve, vartësve pacientëve dhe familjarëve, për përdorimin e mjeteve informatike dhe tematike në fushat me kompetenca specifike. Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 4 semestra dhe me një numër në total 120 Kredite. Programi i lëndëve në vitin e parë të studimit është ideuar që të mundësojë pajisjen e studentëve me njohuri më të thelluara në nivelin teorik dhe praktik në lëndë të shkencave infermieristike si: “Shkenca komunikimi”, “Metodologjia e kerkimit shkencor”, “Urgjencat kirurgjikale dhe menaxhimi infermieror”, “Menaxhimi i mjekësisë interne”, “Menaxhimi i pacientëve në specialitete”, Shkenca interdisiplinare dhe Lëndë me zgjedhje. Programi i lëndëve në vitin e dytë të studimit përfshin: “Patologjitë kardiovaskulare”, “Urgjencat mjekësore”, “Menaxhimi në kirurgji dhe anestezi”, “Shëndeti mendor”, Praktika dhe Mikroteza. Evidenca: <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri</i> <i>Evidenca 91.Plani mesimor MSc. Infermieri</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Infermieri”;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës	Neni 96, pika 3 e Rregullores së UMT përcakton se përfundimi i një programi Master i Shkencave përmbyllet me punim diplome. Kjo përcaktohet dhe në nenin 27, pika 3, të Rregullores së Njësisë Kryesore dhe në nenin 15 të Rregullores së programit

profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	të studimit. Provimi i diplomës bëhet në tre sesione diplomimi të cilat percaktohen nga Dekani i Fakultetit. Studenti që nuk paraqitet ose vlerësohet negativisht në sesionin e parë të provimeve, ka të drejte të paraqitet në provim në sesionin e ardhshëm. Departamenti përcakton datën e zhvillimit të provimit të diplomes. Detyrimet përmbyllëse kanë në total 16 kredite. Neni 33 i Rregullores së FSHMT përcakton praktikat profesionale. Praktika profesionale është e parashikuar në Programin e studimit Master i Shkencave në “Infermieri” dhe ka 12 kredite. Evidenca: <i>Evidenca 9 Udhezues per hartimin e temes se diplomes</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri</i> <i>Evidenca 91.Plani mesimor MSc. Infermieri</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Infermieri”;</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.

krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri”, në UMT është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe, në dijeninë e GVJ, as programi i studimit dhe as Institucioni nuk gëzojnë status të veçantë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” ka ngjashmëri me programe të tjera të së njëjtës fushë që ofrohen në IAL të tjera publike e private. Kjo u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë. Përmbajtja në nivelin 70% nuk është ende përfunduar nga MAS. UMT ka bërë kodifikimin sipas udhëzimit të MAS. Evidenca: <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	UMT ka bërë kodifikimin sipas udhëzimit të MAS, gjithashtu ka zhvilluar dhe kodifikimi i lëndëve. Evidenca: <i>55.1.Lista e kodeve te programeve FSHMT.pdf</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë.</i>

Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit është i organizuar, në përputhje me elementet e kërkuara ligjore, në veprimtari formuese të emërtuara në kredite europiane. Ky është një program studimi me 120 kredite (ECTS). Aktiviteti përfshin në total 3000 orë nga të cilat 1405 orë në auditor dhe 1595 jashtë auditorit. Nga plani mësimor lëndët janë ndarë në: Lëndë Bazë (12 kredite, 10%), Lëndë Karakterizuese (61 kredite, 51%), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (19 kredite, 16%), Lëndë Plotësuese (12 kredite, 10%) dhe Detyrime Përmbyllëse (16 kredite, 13%).</i> <i>GVJ konstatoi se shpërndarja e veprimtarive formuese në Planin mësimor për programin Master i Shkencave në "Infermieri" bëhet në bazë të moduleve dhe jo lëndëve. Kjo bie ndesh me VKM 41, 24. 01. 2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL", prandaj <u>GVJ rekomandon që të bëhet rishikimi i planit mësimor në përputhje me VKM 41, 24. 01. 2018.</u></i> <i>Detyrimet përmbyllëse kanë në total 16 kredite. Praktika profesionale është e parashikuar në Programin e studimit Master i Shkencave në "Infermieri" dhe ka 12 kredite.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse	UMT, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i

për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.03, datë 27.01.2023 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 6 vite, deri në 26.01.2029. FSHMT, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 3 njësi bazë:

- Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji;
- Departamenti i Lëndëve Klinike, Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri;
- Departamenti i Lëndëve Paraklinike;

FSHMT si njësi përgjegjëse për programin e studimit, për vitin akademik 2023-2024 ka në përbërjen e tij gjithsej 305 staf akademik, nga ku 63 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 242 staf akademik me kontratë (PAK) me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	
	PAE	PAK
Prof.Dr	6	1
Prof.Asoc	17	6
Dr/PhD	35	39
Msc	5	196
Gjithsej	63	242

Cdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku shumica prej tyre (92 %) janë me tituj dhe grada shkencore, Prof, Prof.As dhe Dr. Pavarësisht se numri i stafit është i qëndrueshëm, *GVJ konsideron rritjen e numrit të stafit të brendshëm.*

Sa më sipër, fakulteti përmbush detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me numrin e personelit akademik, kualifikimet, ngarkesën, numrin e lëndëve të zhvilluara dhe përputhshmërinë e lëndës me përgjegjësin e saj.

Evidenca:

Evidenca 1 Statuti i UMT;

Evidenca 2 Rregullore e UMT;

Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore;

	<i>Evidenca 77 Vendimi për Akreditimin Inst. të UMT</i> <i>Evidenca 25 Vendimi për licesimin e programit msc infermieri RVB- MSH në Infermieri;</i> <i>Evidenca 97 Tabela përmbledhese</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Neni 33 i Rregullores së FSHMT përcakton rolin dhe detyrimet e drejtuesit të praktikës i cili është personel akademik me kohë të plotë. Gjithashtu, përcaktohet dhe roli i laborantit. DLKIPISBP ka rekrutuar 85 mbikqyrës së praktikës profesionale (mentorë) dhe ka tre laborantë (dy me Msc dhe një me Dr). Për mbikqyrjen dhe mbarëvatjen e praktikave profesionale, FSHMT ka përgatitur dhe Ditarin e Praktikave Profesionale që bën të mundur ndjekjen dhe vlerësimin e studentit. Stafi mbikqyrës së praktikës profesionale i raportuar nga Institucioni janë staf i spitaleve universitare. Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Evidenca 97 Tabela përmbledhese;</i> <i>Evidenca 13.1; 13.2; 13.3 Ditar i praktike</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinators të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të nenit 10 të Rregullores së departamentit, Koordinator i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit dhe praktikave profesionale. Paralelisht, ai informon drejtuesin e departamentit për problematikat e ndryshme. Koordinator propozohet nga drejtuesi i departamentit dhe miratohet nga Dekani. Kjo procedurë u konfirmua dhe në takimin me Drejtuesit e Njësive kryesore/Bazë, por nuk kishte një emër konkret se kush ishte koordinatori i programit. <i>Në takimin me studentët, ata raportuan se nuk ishin në dijeni për koordinatorsin e programit të studimit. GVJ konsideron se Njësia Bazë duhet të vendosë dhe informoj rregullisht studentët për koordinatorsin, detyrat e tij si dhe asistencën që mund të japi atyre.</i> Evidenca:

	<i>Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët.</i>			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamentet, përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Infermieri, janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit ne fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.</i> <i>Departamenti ka në përbërje staf ndihmës akademik. Koordinator i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe mbarvajtjen e programit dhe praktikave profesionale nuk ekziston. GVJ konsideron se Njësia Bazë duhet të vendosë dhe informoj rregullisht studentët për koordinatorin, detyrat e tij si dhe asistencën që mund tu japi atyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm nga Njësia Bazë. Statuti dhe Rregullorja e Institucionit përcaktojnë rregullat e përgjithshme ndërsa me më shumë informacione për këtë program studimi (Master i Shkencave në “Infermieri”) paraqiten në Rregulloren e Njesisë Kryesore, Njesisë Bazë dhe në rregulloren e programit të studimit. Në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë ata raportuan se i gjithë dokumentacioni është i disponueshëm pranë Njesisë Bazë përfshirë rregulloren, planin mësimor, syllabuset si dhe literaturën bazë. GVJ konsideron se stafi akademik duhet të informohet për të gjithë dokumentacionin e disponueshëm pasi në takimin e zhvilluar, disa nga ata nuk ishin në dijeni.

	<i>GVJ rekomandon që rregullorja e Programit të Studimit dhe Rregullorja e Departamentit duhet të jenë më të detajuara dhe më orjentuese për stafin akademik dhe studentët.</i> Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UMT;</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri</i> <i>Evidenca 91.Plani mesimor MSc. Infermieri</i>																																				
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Ky është një program studimi me 120 kredite (ECTS). Aktiviteti përfshin në total 3000 orë nga të cilat 1405 orë në auditor dhe 1595 jashtë auditorit. Nga plani mësimor lëndët janë ndarë në: Lëndë Bazë (12 kredite, 10%), Lëndë Karakterizuese (61 kredite, 51%), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (19 kredite, 16%), Lëndë Plotësuese (12 kredite, 10%) dhe Detyrime Përmbyllëse (16 kredite, 13%). Plani mësimor prezanton lëndët nëse janë semestrale apo vjetore, kategorinë (A-F), nr. e provimeve, kreditet, ndarja e orëve në kredite, ndarja e orëve në semestër dhe totalin e orëve në auditor. <table><tr><th>MSh në "Infermieri"</th><th>Viti I</th><th>Viti II</th><th>Në total</th></tr><tr><td>Në auditor</td><td>669</td><td>793</td><td>1462</td></tr><tr><td>Leksione</td><td>432</td><td>186</td><td>618</td></tr><tr><td>Seminare</td><td>84</td><td>51</td><td>135</td></tr><tr><td>Laboratore</td><td></td><td>96</td><td>96</td></tr><tr><td>Praktike lëndore</td><td>145</td><td>160</td><td>305</td></tr><tr><td>Praktika profesionale</td><td></td><td>300</td><td>300</td></tr><tr><td>Detyra/Projekte</td><td>8</td><td></td><td>8</td></tr><tr><td>Punë e pavarur e studentit</td><td>831</td><td>707</td><td>1538</td></tr></table>	MSh në "Infermieri"	Viti I	Viti II	Në total	Në auditor	669	793	1462	Leksione	432	186	618	Seminare	84	51	135	Laboratore		96	96	Praktike lëndore	145	160	305	Praktika profesionale		300	300	Detyra/Projekte	8		8	Punë e pavarur e studentit	831	707	1538
MSh në "Infermieri"	Viti I	Viti II	Në total																																		
Në auditor	669	793	1462																																		
Leksione	432	186	618																																		
Seminare	84	51	135																																		
Laboratore		96	96																																		
Praktike lëndore	145	160	305																																		
Praktika profesionale		300	300																																		
Detyra/Projekte	8		8																																		
Punë e pavarur e studentit	831	707	1538																																		

	Gjithsej 1500 1500 3000
	GVJ konstaton se orët individuale të studentit për semestrin e dytë janë më pak se gjysma e totalit të orëve vjetore, por orët e studentit në total për gjithë programin e studimit janë më shumë se 50%. <u>GVJ sygjeron që orët e laboratorëve mund të ulen pak duke rritur orët e praktikës profesionale dhe gjatë hartimit të planit mësimorë të jenë më të kujdesshëm me përllogaritjen e orëve.</u> Evidenca: <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri</i> <i>Evidenca 91.Plani mesimor MSc. Infermieri</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Neni 4 i Statutit të Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen student vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Neni 108 i rregullores së Institucionit UMT përcakton mundësinë e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njesisë Kryesore, në nenet 35 dhe 36 raportohet mbi transferimet e mundshme si dhe njohjeve të krediteve. Neni 46; 47; 48 i Rregullores së Departamentit përmend Njohjen dhe Ekuivalentimin e studimeve, diplomave dhe kalimin nga një program studimi në një tjetër. Në rregulloren e programit të studimit neni 10 përcakton kriteret e regjistrimit. <u>Procedura e transferimi nuk është e detajuar/specifikuar.</u> Neni 31 dhe 32 i Rregullores së Njesisë Kryesore përcakton shkëputjen dhe ndërprerjen e studimeve. Kriteret e pranimit dhe kuotat për program studimi miratohen nga Senati Akademik. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UMT;</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP;</i>

	<i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 98.1 Tabela me statistikat e studenteve;</i> <i>Evidenca 132.Procedura dhe praktika e pikezimit dhe renditjes se aplikanteve ne prog. e ciklit I dhe te integruar;</i> <i>Evidenca 133 Publikimi i kritereve te pranimi - ciklit i parë dhe PICD;</i> <i>Evidenca 135 Praktike per miratimin e kritereve te pranimi ciklit i pare dhe integruar;</i> <i>Evidenca 137 Praktike per miratimin e kuotave ciklit i pare dhe integruar;</i> <i>Evidenca 139 Procedura per miratimin e kritereve dhe kuotave te pranimi ne c1, PICD dhe te ciklit te dyte ne UMT</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Sipas nenit 9 të Rregullores së FSHMT, stafi akademik është i detyruar të hartoj programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzojë atë në Departament. Syllabuset përmbajnë, titullin e mësuesit, lektorin, ngarkesën, kohën e realizimit, llojin e lëndës, një përmbledhje dhe rezultatet e të nxënies, konceptet themelore dhe temat e lëndës. Metodologjia e mësimdhënies, forma e kontrollit të dijeve, literatura dhe kodi i etikës paraqitet në syllabuset e dorëzuara. <i>Pjesa më e madhe e syllabuseve ishin të papërditësuara në literaturë nuk kishin gjithë elementet e parashikuara në VKM 41, 2018.</i> <u><i>GVJ sugjeron të rishikohen syllabuset në përputhshmëri me VKM 41, 2018, dhe të përditësohet literatura. Elementët kryesor që çdo syllabus duhet të ketë, është e nevojshme të përfshihen në rregulloren e Departamentit.</i></u> Në takimin me stafin akademik ata raportuan se çdo fillim viti dorëzojnë syllabuset me ndryshimet/përmirësimet përkatëse. Një kopje e syllabusit i vete dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave. <i>Nga takimi me Zyrën e Kurrikulave u tha që kishin bërë disa herë kërkesë për përditësim të programeve të lëndëve, por nuk kemi një evidencë për këtë.</i> Evidenca: <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP</i>

	<i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 92 Silabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i> <i>Takimi me Zyrën e Kurrikulave</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Infermieri" ofrohet që prej vitit 2009 bazuar në VKM Nr. 1184, datë 03.12.2009. Programi i studimit është në proces përmirësimi të vazhdueshëm. Kjo u përmend në takimin me Drejtuesit e Njësive Kryesore/Bazë. Ata raportuan se në fillim të çdo viti akademik bëhen rregullime nëse është e nevojshme, pasi miratohen në Departament. Studentët raportuan se ata pyetishin nga pedagogët për mundësi përmirësimi të programit të lëndëve por nuk kishin marrë pjesë në procedurë për përmirësimin e programit të studimit. Edhe stafi akademik, në takimin e zhvilluar raportuan se nuk kanë marrë pjesë në procedurë për përditësimin e programit të studimit. Në takimin e zhvilluar me përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, ata raportuan se bëjnë shkresë për të identifikuar ndryshimet në syllabus, por nuk kemi evidencë nga ana tyre. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se çdo fillim viti dorëzojnë syllabuset me ndryshimet/përmirësimet përkatëse. Një kopje e syllabusit i vete dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave. <u><i>GVJ sugjeron se programi i studimit duhet të përditësohet rregullisht në bazë të ndryshimeve shkencore. Formalizimi i kësaj procedure si dhe diskutimi i përditësimeve të mundshme në Departament (me përfshirjen e studentëve) është e nevojshme.</i></u> Evidenca: <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri</i> <i>Evidenca 91. Plani mesimor MSc. Infermieri</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqësuesit e Kurrikulave Mësimore.</i>

Konkluzione	<i>Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm nga Njësia Bazë. Ky është një program i ciklit të dytë dhe ka në total 120 kredite (ECTS). Plani mësimor prezanton lëndët nëse janë semestrale apo vjetore, kategorinë (A-F), nr. e provimeve, kreditet, ndarja e orëve në kredite, ndarja e orëve në semestër dhe totalin e orëve në auditor.</i> <i>GVJ rekomandon se orët e laboratorëve mund të ulen pak duke rritur orët e praktikës profesionale.</i> <i>GVJ rekomandon të rishikohen syllabuset në përputhshmëri me VKM 41, 2018, dhe të përditësohet literatura. Elementët kryesor që çdo syllabus duhet të ketë, është e nevojshme të përfshihen në rregulloren e Departamentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Synimi themelor i këtij programi studimi lidhet me kontributin në rritjen e cilësisë profesionale të të diplomuarve në nivelin bachelor dhe që duan të vazhdojnë më tej karrierën profesionale duke u specializuar në fushën e Infermierisë. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në perfundim të tij dhe mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara në kurset teorike dhe praktike për arsye të karakterit të mirëfilltë shkencor të tij dhe njohurive nga fusha e infermieristikës, duke synuar në përgatitjen ose kualifikimin mëtejshëm të studentëve për punësim. Programi i studimit Master i Shkencave në Infermieri ka për qëllim të përgatisë dhe formojë një figurë specialisti në infermieristikë, një profesionist të aftë që të sigurojë mbarvajtjen e proceseve dhe ecurinë e asistencës në

	fushën e infermieristikës se përgjithshme dhe speciale për të rritur dhe për fëmijë. Në këtë program kanë mundësi të studiojnë infermierë të cilët kanë kryer arsim tre vjecar (cikli i pare Bachelor) në degën e Infermierise se përgjithshme dhe kërkojnë të thellojnë me tej njohuritë e tyre në shkencat infermieristike. Pjesa më e madhe e studentëve që ndiqnin këtë program studimi kishin përfunduar programin Bachelor në “Infermieri” pranë UMT. Në takimin me sekretarinë mësimore, u raportua se çdo vit rreth 100 të diplomuar nga programi Bachelor, regjistrohen në këtë program studimi. Në takimin e zhvilluar me studentët, ata pohuan se njohuritë e marra u japin mundësinë atyre si për punësim. Të dhënat e ALUMNI për punësimin e studentëve në këtë program janë rreth 97% brenda apo jashtë vendit. Evidenca: <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Infermieri”;</i> <i>Evidenca 98 Tabela me statistikat e studenteve MSc. Infermieri (regjistrim, transferim, diplomim)</i> <i>Evidenca 108 Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me sekretarinë mësimore.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërimit shkencor.	Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 4 semestra, 2 vite dhe me një numër në total 120 Kredite. <i>Programi i lëndëve në vitin e parë të studimit është ideuar që të mundësoje pajisjen e studentëve me njohuri më të thelluara në nivelin teorik dhe praktik në lëndë të shkencave infermieristike si: Shkenca komunikimi, Metodologjia e kerkimit shkencor, Urgjencat kirurgjikale dhe menaxhimi infermieror, Menaxhimi i mjekësisë interne, Menaxhimi i pacientëve në specialitete, Shkenca interdisiplinare dhe Lëndë me zgjedhje.</i> <i>Programi i lëndëve në vitin e dytë të studimit përfshin: Patologjitë kardiovaskulare, Urgjencat mjekësore, Menaxhimi në kirurgji dhe anestezi, Shëndeti mendor, Praktika dhe Mikroteza.</i> Ky program studimi ka në total 15 lëndë dhe 31 module ku janë parashikuar 15 provime, përfshirë këtu mbrojtja e diplomës.

	Lëndët e modulet e këtij programi studimi janë të ndara në dy vite (4 semestra). Secila lëndë ka një numër të caktuar kreditesh. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen objektivat e përgjithshme ndërsa në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara qartë objektivat formuese si dhe rezultatet e të nxënit. Në takimet e zhvilluara në Institucion, u raportua se përmes lëndëve/moduleve, është e mundur arritja e objektiveve të këtij programi studimi. Evidenca: <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Evidenca 91 Plani mesimor MSc. Infermieri 23-26</i> <i>Evidenca 92 Silabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit përfshin orë brenda dhe jashtë auditorit. Në total ky program ofrohet në një vit akademike dhe kërkon angazhimin për 3000 orë (1405 brenda në auditor dhe 1595 jashtë). Programi përfshin teori dhe praktikë. Programi i studimit është i ngjashëm me programe të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë raportuan Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë në takimin e zhvilluar. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen qartë orët e teorisë dhe praktikës. Në total studentët gjatë studimeve të tyre zhvillojnë 618 orë leksione, 135 orë seminare, 95 orë laboratore, 16 orë detyra/projekte dhe 540 orë praktikë profesionale. <u>GVJ sugjeron</u> se orët laboratorike mund të ulen dhe të rriten orët e praktikës. Evidenca: <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Evidenca 91 Plani mesimor MSc. Infermieri 23-26</i> <i>Evidenca 92 Silabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>

Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Disiplinat mësimore të programit të studimit Master i Shkencave në Infermieri, janë të organizuara në pesë kategori, nga A tek E. Veprimtaritë formuese grupohen në Lëndë Bazë (12 kredite, 10%), Lëndë Karakterizuese (61 kredite, 51%), Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose Integruese (19 kredite, 16%), Lëndë Plotësuese (12 kredite, 10%) dhe Detyrime Përmbyllëse (16 kredite, 13%). Plani mësimor përcakton të detajuar kreditet për secilën lëndë. Neni 4 i Statutit të Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen student vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Neni 108 i rregullores së Institucionit UMT përcakton mundësinë e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njësisë Kryesore, në nenet 35 dhe 36 raportohet mbi transferimet e mundshme si dhe njohjeve të krediteve. Mobiliteti është i mundur në kuadër të këtij programi studimi dhe u raportua nga Drejtuesit e Njësisë Kryesore/Bazë si dhe nga studentët. Në përfundim të studimeve, punësimi është i mundur. GVJ vëren se vetëm një pjesë e vogël e të diplomuarve nuk punojnë në profilin e tyre. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UMT;</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 98.1 Tabela me statistikat e studenteve;</i> <i>Evidenca 91 Plani mesimor MSc. Infermieri 23-26;</i> <i>Evidenca 167 Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore UMT</i> <i>Evidenca 166 Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët;</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në	Pedagogu i lëndës harton programin mësimor në bazë të objektivave të programit të studimit si dhe në bazë të ecures së shkencës së infermierisë. Syllabusi dorëzohet dhe miratohet në



mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Departament nga Drejtuesi i Njesisë Bazë. Sipas nenit 9 të Rregullores së FSHMT, stafi akademik është i detyruar të hartoj programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzoj atë në Departament. Literatura bazë dhe e rekomanduar përfshihet në të gjithë syllabuset e dorëzuara. <i>Pjesa më e madhe e syllabuseve ishin të papërditësuara në literaturë nuk kishin gjithë elementet e parashikuara në VKM 41, 2018. <u>GVJ rekomandon që të përditësohet literatura në syllabuse.</u></i> Nga dokumentat e dorëzuara, kërkesa e fundit për pasurimin e bibliotekës <i>ishte viti 2018</i>. Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë e justifikuan këtë për shkak të librave on-line. Në takimin me studentët, ata raportuan se e frekuentojnë bibliotekën. Evidenca: <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP;</i> <i>Evidenca 91 Plan i mesimor MSc. Infermieri 23-26;</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Evidenca 92 Syllabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Evidenca 113 Biblioteka FSHMT;</i> <i>Evidenca 114 Bibliotekat online - lista dhe përshkrim;</i> <i>Evidenca 24 Udhëzues biblioteka online;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me përfaqësues të Komisionit për Kurrikulat</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” u mundëson studentëve përfitimin e njohirive, aftësive dhe kompetencave të synuara. Objektivat e programit të studimit janë të prezantuar në Rregulloren e programit si dhe në syllabuset respektive. Kjo gjë u raportua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë. Përfshirja e teorisë dhe praktikës rrit kompetencat e studentëve për përdorimin e tyre gjatë punësimit. Evidenca:

	<i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 92 Silabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ky është një Master i Shkencave dhe studentët kanë mundësinë të vazhdojnë studime doktorale në përfundim të këtij programi apo të punësohen. Cikli i tretë i studimeve ofrohet nga vetë institucioni UMT, gjë që lehtëson procedurat për ata që duan të vazhdojnë studimet doktorale. Nga të dhënat e ALUMNI 97% e studentëve të këtij programi janë të punësuar. Evidenca: <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 55 Lista e programeve të studimit të ofruara në UMT</i> <i>Evidenca 108 Aktivitete të Zyres së Karrierës FSHMT</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët.</i>			
Konkluzione	<i>Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale. Në total studentët gjatë studimeve të tyre zhvillojnë 618 orë leksione, 135 orë seminare, 95 orë laboratore, 16 orë detyra/projekte dhe 540 orë praktikë profesionale.</i> <i><u>GVJ sugjeron se orët laboratorike mund të ulen dhe të rriten orët e praktikës. Nuk u raportuan mobilitete për studentët e këtij programi studimi, por institucioni ofron për studentët mundësi mobiliteti. Janë mbi 10 marrëveshje me projekte Erasmus +. Ka një përfshirje të stafit akademik në këto projekte. Pjesa dërrmuese e studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi janë të punësuar (rreht 97%). Syllabuset e dorëzuara kishin literaturë të vjetër. GVJ rekomandon që të përditësohet literatura në syllabuse.</u></i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	UMT ofron programe studimi të përshtatura me tregun e punës. Drejtuesia e Njesisë Kryesore raportoi se janë munduar të përshtasin programet e studimit sipas nevojave. Institucioni raporton se mundohet brenda 20% të përshtasi programin e studimit. Nuk u dhanë evidenca nga institucioni për përfshirjen e alumni apo partnerëve në përmirësimin e programit të studimit. Stafi akademik raportoi se rol kryesor në përmirësimin e programit të studimit ka përgjegjësi i departamentit. Në takimin e organizuar me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave ata raportuan se nuk janë përfshirë institucione partnere ose alumni dhe aktorë të tjerë për përmirësimin e programit të studimit. <i>GVJ sugjeron se Institucioni duhet të punoj më shumë në këtë pikë. Përfshirja e këtyre grupeve do ti japi mundësinë UMT të përmirësoj programin e studimit akoma më tepër.</i> Evidenca: - Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në	Sipas parashikimeve ligjore, Senati Akademik i UMT, ka në përbërjen e vet dhe student, neni 25, pika 3 Statuti i UMT. Paralelisht, Institucioni ka ngritur dhe Këshillin studentor. Studentët janë dhe anëtarë të komisioneve të ndryshme që Institucioni ngre (përfshirë këtu edhe procesin e akreditimit). Gjithashtu ekzistone senatori i klasës i cili bënte urën lidhëse midis studentëve dhe strukturave dhe funksiononte më së miri. Këto u konfirmuan edhe në takimin e zhvilluar me studentët. Nga ana tjetër, raportuan se kanë gjithnjë një derë të hapur nga

ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Drejtuesia e Njesisë Kryesore në rast se kanë problematika të ndryshme. Studentët raportuan se janë thirrur nga Drejtuesi i Departamentit dhe kanë dhënë mendimin e tyre për organizimin e konferencës. Vlerësimi i stafit akademik nga studentët është diçka pozitive. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UMT;</i> <i>Evidenca 126 Rregullore e zgjedhjeve të Keshillit Studentor UMT</i> <i>Evidenca 125 Perberja e Keshillit Studentor UMT</i> <i>Evidenca 127 Statuti i Keshillit Studentor UMT</i> <i>Evidenca 15 Aktivitete studente libri i abstrakteve konferenca e shkencave mjekësore;</i> <i>Evidenca 27 Pyetësi i studentëve fshmt 23;</i> <i>Evidenca 28 Rezultatet pyetësorit studentët 23</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	UMT nuk raportoi bashkëpunime të ndryshme me Urdhërin e Infermierit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Drejtuesit raportuan se mundohen të përditësojnë programin e studimit në bazë të ndryshimeve të fundit. Edhe stafi akademik e raportoi këtë gjatë takimit të zhvilluar. Institucioni ka raportuar komunikimin zyrtar me UISSH me qëllim identifikimin e kalueshmërisë në provimin e licensës. <i>GVJ konsideron të rëndësishme ndërtimin e marrëdhënieve me UISSH për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit.</i> Evidenca: <i>Evidenca 11 Praktike për miratimin e planeve mesimore;</i> <i>Evidenca 11.1 Relacioni rishikimin e programit MSc. Infermieri</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>
Konkluzione	<i>Institucioni raporton se mundohet brenda 20% të përshtasi programin e studimit. <u>Nuk janë përfshirë</u> institucione partnere ose alumni dhe aktorë të tjerë për përmirësimin e programit të studimit. Studentët raportuan se nuk janë përfshirë në përmirësimin e programit të studimit. UMT nuk raportoi</i>

	<i>bashkëpunime të ndryshme me Urdhërin e Infermierit me qëllim përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Misioni dhe Veprimtaria e programit të studimit janë të përcaktuara qartë në Nenin 6 & 7 të Rregullores së programit të studimit. Objektivat e përcaktuara janë në përputhje me objektivat e institucionit siç ato janë të përcaktuara në Statut, Rregullore të Institucionit dhe Strategjinë e Zhvillimit. Ky program studimi ka objektiva të përgatisë specialistë/profesionistë me kapacitete profesionale dhe didaktike në fushën e shkencave infermiore të avancuara, mendimit kritik dhe aftësive të studentëve të infermierisë, për të qenë të aftë të hyjnë në menaxhimin e një studimi të fushës, si dhe përfshirjen e tyre në studime me kolegët apo pedagogët. Programi i studimit ka për objektiv të përgatisë infermierë me formim të avancuar për të ofruar jo vetëm kujdes shëndetësor të kualifikuar për individët në nevojë, por dhe të ndihmojnë menaxherët e institucioneve të kujdesit shëndetësor me studime mbi tregun e punës, sëmundje dhe epidemiologjinë e tyre apo dhe në aspekte të ndryshme të kujdesit shëndetësor. Në takimin e zhvilluar me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë, ata raportuan se kërkimi shkencor është një pikë prioritare për UMT dhe për këtë arsye, Institucioni ka përcaktuar një fond (1,000 euro për çdo pedagog) për punime shkencore. Stafi ka përfutur nga ky grant. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UMT;</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i>

	<i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 152 Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT</i> <i>Evidenca 153.1 Raportim i aktivitetit shkencor personel akademik 20-23</i> <i>Evidenca 153 Raportimi i aktivitetit shkencor i departamentit 20-23</i> <i>Evidenca 154 Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i> <i>Evidenca 181 Rregullore mbi botimet mesimore shkencore ne UMT</i> <i>Evidenca 182 Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Botimeve UMT VSA nr.42 datë 29.04.2022;</i> <i>Evidenca 146 Serbimi i Telemjekesise</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Stafi akademik gëzon liri akademike në kërkim shkencor dhe mësimdhënie. Ata hartojnë syllabusin si dhe zhvillojnë kërkim shkencor në bazë të preferencave të tyre. Sipas nenit 9 të Rregullores së FSHMT, stafi akademik është i detyruar të hartoj programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzoj atë në Departament. Departamenti ka për detyrë të organizojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe Kërkimit Shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit. Evidenca: <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të	Studentët kanë mundësinë të përdorin Konferencën Studentore për publikimin e punimeve të tyre. Stafi akademik raportoi se përfshin studentët në aktivitete kërkimore. Institucioni ka

angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	organizuar dhe një konferencë shkencore studentore ku studentët kishin mundësinë të merrnin pjesë dhe të prezantonin punimet e tyre. Kërkimi shkencor përfshihet në planin mësimor. Evidenca: <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 91 Plani mesimor MSc. Infermieri 23-26;</i> <i>Evidenca 15 Aktivitete studente libri i abstrakteve knonferenca e shkencave mjekesore;</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Njësia Bazë nuk administron të ardhura por ato menaxhohen në nivel Institucioni. Gjatë takimit me Drejtuesin e Njesisë Kryesore/Bazë ata raportuan se nuk administrojnë të ardhura. Stafi akademik raportoi se është mbështetur financiarisht për publikimin e artikujve dhe punimeve shkencore. Kjo është një praktikë e shumë e mirë. Evidenca: <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>			
Konkluzione	<i>Misioni dhe Veprimtaria e programit të studimit janë të përcaktuara qartë në Nenin 6 & 7 të Rregullores së programit të studimit. Stafi akademik gëzon liri akademike në kërkim shkencor dhe mësimdhënie. Stafi akademik raportoi se është mbështetur financiarisht për publikimin e artikujve dhe punimeve shkencore. Kjo është një praktikë shumë e mirë</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7



Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë raportuan se mundohen të aplikojnë në projekte kërkimore shkencore. Anëtarët e GVB raportuan se kërkimi shkencor është një pikë e fortë, por që duhet të duhet të punohet më shumë. <i>GVJ konsideron të rëndësishme dhe sugjeron që numëri i aplikimeve në projekte kërkimore shkencore të rritet.</i> Evidenca: <i>Evidenca 152 Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT</i> <i>Evidenca 153.1 Raportim i aktivitetit shkencor personel akademik 20-23</i> <i>Evidenca 153 Raportimi i aktivitetit shkencor i departamentit 20-23</i> <i>Evidenca 154 Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i> <i>Evidenca 181 Rregullore mbi botimet mesimore shkencore ne UMT</i> <i>Evidenca 182 Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Botimeve UMT VSA nr.42 datë 29.04.2022;</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me GVB;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Në kuadër të kërkimit shkencor stafi akademik dhe studentët kanë mundësinë të përdorin ambientet e UMT. Në raportin vjetor të Njesisë Bazë prezantohen publikimet e stafit akademik, ndërsa në mënyrë të përmbledhur paraqiten në raportin vjetor të Njesisë Kryesore dhe Institucionit. Evidenca: <i>Evidenca 79; 79.1 Raporti Vjetor UMT</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT</i> <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>



Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Institucion raporton se organizon rregullisht aktivitete të ndryshme si konferenca, leksione të hapura, workshope etj. të cilat u vinë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve. Paralelisht, ka organizuar konferencë studentore. Aktivitetet e organizuara raportohen sin ë raportin e Njesisë Bazë edhe në raportin vjetor të Institucionit. Evidenca: <i>Evidenca 79; 79.1 Raporti Vjetor UMT</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT</i> <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP</i> <i>Evidenca 152 Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT</i> <i>Evidenca 153.1 Raportim i aktivitetit shkencor personel akademik 20-23</i> <i>Evidenca 153 Raportimi i aktivitetit shkencor i departamentit 20-23</i> <i>Evidenca 154 Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i> <i>Evidenca 181 Rregullore mbi botimet mesimore shkencore ne UMT</i> <i>Evidenca 182 Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Botimeve UMT VSA nr.42 datë 29.04.2022;</i> <i>Evidenca 146 Serbimi i Telemjekesise</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit formon profesionistë për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Përqindja e lartë e suksesit në provimin e licensës është një evidencë e fortë për këtë. Paralelisht, studentët raportuan se disa do të punonin në Shqipëri ndërsa disa të tjerë do të largoheshin. Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë raportuan se shumë student të tyre largohen dhe punësohen jashtë, gjë që tregon se ky program studimi formon profesionistë konkurrues. Evidenca: <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e	Njësia Bazë duhet të ndërtoj marrëdhënie bashkëpunimi me Urdhërin e Infermierit si dhe shoqatat infermierore në Shqipëri.



nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Kjo do ti japi mundësinë të formoj profesionistë akoma më të përgatitur për tregun e punës.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend si dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe direktivat e Rregullores së Bashkimit Europian. Kjo vërtetohet nga momenti i hapjes së programit të studimit si dhe akreditimi institucional. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UMT;</i> <i>Evidenca 77 Vendimi për Akreditimin Inst. të UMT</i> <i>Evidenca 25 Vendimi për licesnimin e programit msc infermieri RVB- MSH në Infermieri;</i>			
Konkluzione	<i>Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë raportuan se mundohen të aplikojnë në projekte kërkimore shkencore. GJV konsideron të rëndësishme dhe sugjeron që numëri i aplikimeve në projekte kërkimore shkencore të rritet. Në kuadër të kërkimit shkencor staf akademik dhe studentët kanë mundësinë të përdorin ambientet e UMT. Institucion raporton se organizon rregullisht aktivitete të ndryshme si konferenca, leksione të hapura, workshope etj të cilat u vinë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve. Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend si dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe direktivat e Rregullores së Bashkimit Europian.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------

				X
--	--	--	--	---

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																								
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Neni 74 i Rregullores së Institucionit, neni 8 i Rregullores së Njesisë Kryesore dhe neni 13 i Rregullores së programit të studimit, përcaktojnë format e mësimdhënies. Ato janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, laboratorët etj. Paralelisht, në këtë program parashikohen 14 lëndë (sëbashku me praktikën dhe mikrotezën), 29 module dhe 13 provime. Lëndët ndahen në ato të detyrueshme dhe ato me zgjedhje. Plani mësimor përcakton orët e ndryshme për të gjitha format e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen orët e dhe formën që përdoret. Këto forma mësimdhënie u konfirmuan dhe në takimet e zhvilluara me stafin akademik, studentët dhe përfaqësues të sektorit të standardeve të cilësisë dhe kurrikulave. <table><tr><th>Msc në “Infermieri”</th><th>Viti I</th><th>Viti II</th><th>Në total</th></tr><tr><td>Në auditor</td><td>669</td><td>793</td><td>1462</td></tr><tr><td>Leksione</td><td>432</td><td>186</td><td>618</td></tr><tr><td>Seminare</td><td>84</td><td>51</td><td>135</td></tr><tr><td>Laboratore</td><td></td><td>96</td><td>96</td></tr><tr><td>Praktike lëndore</td><td>145</td><td>160</td><td>305</td></tr><tr><td>Praktika profesionale</td><td></td><td>300</td><td>300</td></tr><tr><td>Detyra/Projekte</td><td>8</td><td></td><td>8</td></tr><tr><td>Punë e pavarur e studentit</td><td>831</td><td>707</td><td>1538</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>1500</td><td>1500</td><td>3000</td></tr></table>	Msc në “Infermieri”	Viti I	Viti II	Në total	Në auditor	669	793	1462	Leksione	432	186	618	Seminare	84	51	135	Laboratore		96	96	Praktike lëndore	145	160	305	Praktika profesionale		300	300	Detyra/Projekte	8		8	Punë e pavarur e studentit	831	707	1538	Gjithsej	1500	1500	3000
Msc në “Infermieri”	Viti I	Viti II	Në total																																						
Në auditor	669	793	1462																																						
Leksione	432	186	618																																						
Seminare	84	51	135																																						
Laboratore		96	96																																						
Praktike lëndore	145	160	305																																						
Praktika profesionale		300	300																																						
Detyra/Projekte	8		8																																						
Punë e pavarur e studentit	831	707	1538																																						
Gjithsej	1500	1500	3000																																						



	Evidenca: <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 91 Plani mesimor MSc. Infermieri 23-26;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin bërjen e tij sa më të përshtatshëm për studentët. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Këto metoda u konfirmuan dhe nga studentët. Në periudhën e pandemisë, UMT, ka përdorur dhe mësimdhënien on-line por jo më. Evidenca: <i>Evidenca 146 Serbimi i Telemjekesise</i> <i>Evidenca 147 Pershkrim i funksionaliteteve te platformes E-UMT</i> <i>Evidenca 148 Pershkrim funksionaliteteve te platformes EasyWeb LMS</i> <i>Evidenca 42 Nderfaqe EasyWeb (per lenden)</i> <i>Evidenca 79 Raporti Vjetor _UMT_ 2020-2020</i> <i>Evidenca 85 Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2021</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, UMT, organizon trajnime për stafin akademik. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se Zyra e Kërkimit Shkencor ka marrë ekspert nga jashtë me qëllim zhvillimin e trajnimeve. Paralelisht, u dërgojnë thirrje për aplikime të ndryshmes dhe website. Përfaqësuesit e Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave raportuan se organizojnë aktivitete trajnuese, por



	jo në fushën e didaktikës ndërsa përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin raportuan se përmirësimi i mësimdhënies zhvillohet përmes aktiviteteve trajnuese. Evidenca: <i>Evidenca 146 Sherbimi i Telemjekesise</i> <i>Evidenca 45 Lista e projekteve kombetare te aplikuara dhe te fituara</i> <i>Evidenca 19. Aktiviteti dt 14 Nentor 2023 në FSHMT</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>Takim me përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i cili është i angazhuar në mësimdhënie ka njohuritë dhe aftësitë e duhura. Stafi akademik ka aftësitë e duhura didaktike me qëllim shpjegimin në mënyrën më të mirë të mundshme studentëve. Studentët raportuan se janë të kënaqur nga mësimdhënia që zhvillon stafi akademik. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Kjo u konfirmua nga studentët. Gjatë takimit me autoritete drejtuese, ata raportuan se mundohen të rekrutojnë staf me eksperiencë në mësimdhënie. Kjo u raportua dhe në takimin me Burimet Njerëzore. CV-t e pedagogëve tregojnë se ata kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në mësimdhënie. UMT organizon aktivitete trajnuese për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik. Evidenca: <i>Evidenca 96 CV-te e personelit akademik te angazhuar ne programin e studimit;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqësues të Burimeve Njerëzore.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe	Institucioni ka hartuar dy pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik nga studentët, njëri për lëndën dhe tjeri për institucionin. Kjo është një procedurë standarde që UMT përdor

përmirëson format e metodat e mësimit në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	për të përfshirë studentët në përmirësimin e mësimit. Stafi akademik raportoi se ata vlerësohen nga studentët. Ata raportuan se në vija të përgjithshme informohen për rezultatet. Studentët konfirmuan që vlerësojnë stafin akademik. Ata marrin pyetësorin me email dhe e plotësojnë. Kjo është procedura që raportuan dhe përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Stafi akademik vlerësohet dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Kjo u konfirmua dhe në takimin me stafin akademik. GVJ e konsideron këtë si një praktik të mirë që UMT duhet të vazhdojë ta bëjë, por plotësimi i pyetësorëve në formë elektronike nuk kishte impakt të lartë, GVJ konsideron se është e rëndësishme që pyetësorët të bëhen edhe në format hardcopy, në mënyrë që të kemi gjithëpërfshirje të studentëve në këtë vlerësim. Mungesa e një raporti të tillë u raportua dhe nga përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Ata sugjeruan se një raport i tillë është diçka pozitive. Evidenca: <i>Evidenca 67 Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për lëndet e programit të studimit formular</i> <i>Evidenca 68 Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i> <i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimit, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimit. Strukturat dhe	Institucioni ka në përbërjen e vet Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave. Ata organizojnë aktivitetet të ndryshme duke përfshirë dhe ekspert të jashtëm. Në takimin me përfaqësues të sektorit, ata raportuan se aktivitetet që organizojnë nuk janë konkrete didaktike. GVJ mendon se është e nevojshme të rriten aktivitetet me qëllim përmirësimin e aftësive mësimit të stafit akademik. Evidenca: <i>Evidenca 3 Organigrama UMT;</i>

njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<i>Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.</i>			
Konkluzione	<i>Format e mësimdhënies janë leksionet, seminarët, praktikat profesionale, detyrat e kursit, laboratorët etj. Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin bërjen e tij sa më të përshtatshëm për studentët. Stafit akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. GVJ vëren se trajnimet e stafit akademik janë të përgjithshme dhe jo të specifikuara në nevojat e stafit akademik. Institucioni ka hartuar dy pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik nga studentët. <u>GVJ konsideron se është e rëndësishme që pyetësorët të bëhen edhe në format hardcopy, në mënyrë që të kemi gjithëpërfshirje të studentëve në këtë vlerësim.</u></i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të	Neni 86 i Rregullores së institucionit, neni 16 i Rregullores së Njësisë Kryesore dhe neni 17 i Rregullores së Programit të studimit raportojnë kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të dijeve. Në syllabuset e lëndëve/moduleve raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e

studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	kontrollit të vazhdueshem, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 70% 2. Provimi të ndërmjetëm 15% 3. Aktivizimi 10% 4. Frekuentimi 5% Vlerësimi i tezës së provimit është pjesë e vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit (seminare, laboratore, provimit të ndërmjetëm etj), nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës. Në sezonet e vjeshtës ose të riprovimeve vlerësimi bëhet me tezë 100 pikëshe dhe vlerësimet e studentit të akumuluar gjatë vitit zerohen. Vlerësimi përfundimtar mund të ndryshohet vetëm me rifutjen në provim për përmirësim. Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 4 deri 10), me pikë ose me përgindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Kjo procedurë u konfirmua nga stafi akademik dhe nga studentët gjatë takimeve të zhvilluara. Vlerësimi detajohet në syllabuset e lëndëve.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve	Evidenca: <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Evidenca 92 Syllabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i> Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Ky informacion është po ashtu edhe në syllabuset e lëndëve. Informimi i studentëve orën e parë të modulit u

dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	konfirmua dhe gjatë takimeve si nga stafi akademik po ashtu dhe nga studentët. Evidenca: <i>Evidenca 92 Sillabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas nenit 17 të Rregullores së Njesisë Kryesore kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Në detyrimet e studentit përfshihen si lëndët e detyrueshme dhe ato fakultative: zgjedhja e lëndëve fakultative është në pëlgimin e studentit Njohuritë e përfituara nga studenti, mund të kontrollohen dhe të vlerësohen përmes nje kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, punëve laboratorike dhe provimit me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pike) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4- 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Në syllabusin e çdo lende përcaktohen dhe disiplinoen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagoget ashtu dhe nga studentët. Evidenca: <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Evidenca 92 Sillabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i>

	<i>Takim me studentët.</i>			
Konkluzione	<i>Në rregulloren e Programit të studimit raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të provimi përfundimtar (70%), provimi të ndërmjetëm (15%), (10%) dhe frekuentimi (5%). Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rregulloren e Programit të studimit (neni 16) raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe në syllabuse raportohet se nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: 1. Provimi përfundimtar 70% 2. Provimi të ndërmjetëm 15% 3. Aktivizimi 10%; 4. Frekuentimi 5% ; Sipas nenit 17 të Rregullores së Njesisë Kryesore kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektsh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pike) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4- 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10

	është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Në syllabusin e çdo lende përcaktohen dhe dispijohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagoget ashtu dhe nga studentët. Evidenca: <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Evidenca 92 Sillabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UMT ka marrëveshje me CleanScore për zbatim të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit. Me qëllim vlerësimi të jetë i drejtë dhe i pa anshëm, përdoret sekretimi i provimeve. Sekretimi u konfirmua nga studentët dhe pedagogët dhe kjo është një pikë e fortë e Institucionit. Evidenca: <i>Evidenca 145 Relacion cleanscore;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi zhvillohet në bazë të nenit 88 të Rregullores së institucionit, nenit 16 të Rregullores së Njësisë Kryesore dhe nenit 17 të Rregullores së Programit të studimit. Në këto nene raportohen kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të dijeve. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët. Evidenca:

	<i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Evidenca 92 Sillabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në systemin Pitagora ose në klasë. Studentët raportuan se në raste që kanë paqartësi mund të pyesin pedagogët për gabimet e tyre. Kjo është një procedurë që u konfirmua dhe nga stafi akademik. Evidenca: <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Përdorimi i materialeve të ndaluara, kopjimi etj. nuk lejohen. Në syllabuset e lëndëve është i përcaktuar dhe kodi i etikës ku detajohen veprimet që nuk lejohen nga studentët, përfshirë këtu kopjimin, plagjiaturën etj. Institucioni ka marrëveshje me Akademia për përdorimin një sistem antiplagjature me pagesë. Kjo u konfirmua nga drejtuesit e Njesisë kryesore dhe Njesisë bazë. Evidenca: <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 92 Sillabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Studentët informohen mbi rezultatet e provimit sipas afateve ligjore që parashikohen në Rregulloren e programit të studimit. Korrigjimi i provimeve bëhet nën përgjegjësinë e një pedagogu titullar dhe brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit. Pas korrigjimit, provimet depozitohen pranë departamentit dhe vlerësimi i tyre i bëhet i njohur studentëve nëpërmjet pedagogut dhe sekretarisë mësimore të degës përkatëse. Studentët

	raportuan se njoftohen për pikët e provimit nga pedagogu i lëndës, sistemi Pitagora ose nga sekretaria mësimore. Këtë procedurë e konfirmoi dhe stafi akademik. Evidenca: <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për të kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë, neni 87 i Regullores së Njesisë kryesore. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të degës përkatëse, brenda 25 orëve nga shpallja e rezultateve, neni 92 i Regullores së Njesisë kryesore. Stafi akademik raporoj se ka procedurë për ankimimin e një note por asnjë nga ata nuk kishte patur një çështje të tillë pasi deri tani, çdo problematik ishte mbyllur në nivel Departamenti. Studentët raportuan se janë në dijeni për procedurën e kontestimit të një note, në rast se ata nuk janë dakord. Një prej studentëve raportoi se ka ankimuar notën dhe se u morr në pyetje nga pedagogu i lëndës. Pavarësisht se mundësia e kontestimit përmendet në Rregulloren e Programit të Studimit, <u>GVJ konsideron se kjo procedurë duhet të jepet më e detajuar.</u> Evidenca: <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të	Sipas nenit 92 i Regullores së Njesisë kryesore, çdo ankimim për vlerësim shqyrtohet pasi ka kaluar nga përgjegjësi i departamentit, dërgohet te Dekani i Fakultetit, i cili ngre një komision ad-hoc në përbërjen e të cilit bëjnë pjese edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi lidhur me

jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	rivlerësimin e provimit merret brenda 24 orëve nga dita e depozitimit të ankesës Evidenca: <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i>			
Konkluzione	<i>Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit provimi përfundimtar (70%), provimi të ndërmjetëm (15%), aktivizimi (10%) dhe frekuentimi (5%). UMT ka marrëveshje me CleanScore për zbatim të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët. Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin Pitagora ose në klasë. Institucioni ka marrëveshje me Akademia për përdorimin një sistem antiplagjature me pagesë. Studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin e vlerësimit, të informohen për gabimet e tyre në provim si dhe mundësinë për të kontestuar në rast se nuk janë dakord me vlerësimin. GVJ konsideron se procedura e ankimimit nuk është shumë e qartë dhe Njësia Bazë duhet ta sqarojë këtë duke bërë amendimet e nevojshme në Rregulloren e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në Infermieri garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 4 semestra, 2 vite akademike dhe me një numër në total 120 Kredite.

	Programi i lëndëve në semestrin e parë janë: Shkenca komunikimi, Metodologji e kërkimit shkencor, Urgjencat kirurgjikale dhe menaxhimi infermieror, Menaxhimi në mjekësinë interne, Menaxhimi i pacientëve në specialitete dhe Shkenca interdisiplinare. Ndërsa në vitin e dytë janë planifikuar këto lëndë: Patologjitë kardiovaskulare, Kompetencat infermirore, Urgjencat mjekësore, Menaxhimi në kirurgji dhe anestezi, Shëndet mendor dhe infermieri dhe Praktikat profesionale. Lëndë ndërdisiplinore si Ekzaminimet laboratorike/ Imazherike dhe Gjenetika e avancuar/ Reabilitim në komunitet përfshihen në programin e studimit si lëndë me zgjedhje. Evidenca: <i>Evidenca 91.Plani mesimor MSc. Infermieri 23-26;</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Evidenca 92 Sillabuset Master Shkencor infermieri.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Ky program studimi fokusohet në përgatitjen e infermierëve për tregun e punës. Lëndë ndërdisiplinore si Ekzaminimet laboratorike/ Imazherike dhe Gjenetika e avancuar/ Reabilitim në komunitet përfshihen në programin e studimit si lëndë me zgjedhje. Evidenca: <i>Evidenca 91.Plani mesimor MSc. Infermieri 23-26;</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Evidenca 92 Sillabuset Master Shkencor infermieri;</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe sillabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre,	Në fund të lëndës, pedagogët informojnë dhe orientojnë studentët për çështjet më të rëndësishme. Stafi akademik raportoi se zhvillon konsultime me studentët në orën e fundit të lëndës. Institucioni ka hartuar një raport vjetor, që plotëson stafi akademik në fund të semestrit dhe ku specifikohen objektivat e arritura, literatura e përdorur, frekuentimi, realizimi i programit etj. Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe GVJ e konsideron se pikë të fortë. Studentët raportuan se zhvillojnë konsultime me pedagogët.



si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Evidenca: <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP;</i> <i>Evidenca 86.1; 86.2; 86.3 Programi i studimit MSc. Infermieri;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Gjatë programit të studimit, studentët përfitojnë njohuri dhe kompetenca. Ata zhvillojnë orë seminare, orë laboratorike dhe praktika. Studentët zhvillojnë në total 618 orë leksione, 135 orë seminare, 96 orë laboratore, 8 orë detyra/projekte dhe 605 orë praktikë profesionale dhe lëndore. Stafi akademik dhe studentët raportuan se diskutimi zhvillohet gjatë orëve të mësimit me qëllim rritjen e aftësive dhe kompetencave të studentëve. Studentët raportuan se pedagogët mundohen të krijojnë një klimë positive duke dhënë dhe shëmbuj/raste konkrete nga puna e tyre klinike. Punimet kërkimore të studentëve janë të mundura të publikohen në revistën e FSHMT, pa pagesë. Studentët po ashtu kanë patur mundësinë të prezantojnë punimet e tyre dhe në konferencën studentore të organizuar nga FSHMT. Evidenca: <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 91.Plani mesimor MSc. Infermieri 23-26;</i> <i>Evidenca 152 Lista e botimeve të revistës shkencore të FSHMT</i> <i>Evidenca 15 Aktivitete studente libri i abstrakteve knonferenca; e shkencave mjekesore;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik i DLKIPISBP mundohet të zhvillojë orë të hapura dhe seminare mbi të rejtat e shkencës së Infermierisë. Këtë e raportoi stafi akademik në takimin e zhvilluar. Departamenti ka organizuar orë të hapura gjatë peridhës së kaluar dhe kjo është një praktikë e mirë që duhet të vazhdoj ta bëj. Paralelisht, stafi akademik brenda dhe jashtë strukturës së programit zhvillon studime kërkimore shkencore. Evidenca:



	<i>Evidenca 19. Aktiviteti dt 14 Nentor 2023 në FSHMT;</i> <i>Evidenca 153 Raportimi i aktivitetit shkencor i departamentit 20-23;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UMT mbështet idetë inovative. UMT ka organizuar konferencë studentore. Paralelisht, ambientet e Institucionit mund të përdoren nga studentët për punë kërkimore shkencore. Evidenca: <i>Evidenca 15 Aktivitete studente libri i abstrakteve knonferenca e shkencave mjekesore;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Infermieri" garanton thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 4 semestra, 2 vite akademike dhe me një numër në total 120 Kredite. Lëndë ndërdisiplinore si Ekzaminimet laboratorike/ Imazherike dhe Gjenetika e avancuar/ Reabilitim në komunitet përfshihen në programin e studimit si lëndë me zgjedhje.</i> <i>Institucioni ka hartuar një raport vjetor, që plotëson stafi akademik në fund të semestrit dhe ku specifikohen objektivat e arritura, literatura e përdorur, frekuentimi, realizimi i programit etj. Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe GVJ e konsideron se pikë të fortë. Studentët zhvillojnë në total 618 orë leksione, 135 orë seminare, 96 orë laboratore, 8 orë detyra/projekte dhe 605 orë praktikë profesionale dhe lëndore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në përfundim të kursit të plotë të studimeve (me shlyerjen e plotë të detyrimeve), studenti fiton diplomë "Master i Shkencave" në Infermieri. Procesi i diplomimit realizohet me anë të mbrojtjes së mikrotezës. Në rregulloren e FSHMT shpjegohet i gjithë procesi i diplomimit të studentit. Gjithashtu ka dhe një udhëzues për strukturën e temës së diplomës Evidenca: <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 9 Udhëzues për hartimin e temës së diplomës.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Neni 26, pika 3 e Rregullores së FSHMT, thotë se FSHMT brenda një muaji nga dita e fillimit të vitit akademik, u bën të njohur studentëve të vitit të parafundit temat e diplomave. Dekanati i FSHMT përcakton procedurat që duhet të ndiqen për informimin e studentëve. Diplomimi realizohet në tre sezone. Për studentët që nuk diplomohen në sezonin e diplomimit (sezoni i verës), mund të diplomohen në dy sezonet e pasardhëse (sezoni i vjeshtës dhe i dimrit). Studenti ka të drejtë të riparaqitet në provimin e diplomës, deri në pesë herë. Afatet përcaktohen nga Dekani i FSHMT. Evidenca: <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekani, i përbërë minimalisht nga dy anëtarë, ka përgjegjësinë e realizimit dhe mbarëvajtjes të të gjithë procesit të mbajtjes së diplomës me mikrotezë. Gjithashtu ka dhe një udhëzues për strukturën e temës së diplomës. Evidenca: <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP;</i> <i>Evidenca 9 Udhëzues për hartimin e temës së diplomës.</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>

Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Sipas nenit 14 të Rregullores së Studimit Msc në Infermieri, çdo student duhet të mbyllë detyrimet përfundimtare me anë të realizimit të temës së diplomës. Studenti zgjedh pedagogun udhëheqës. Para dorëzimit në departament udhëheqësi shkencor plotëson për secilin nga studentët që ka pasur në kujdes një formular vlerësimi, i cili i përcillet komisionit të vlerësimit. Studenti duhet të dorëzojë në departament temën e diplomës para datës së mbrojtjes, të printuar në word. Manuali i punimit të diplomës është në dispozicion të studentëve. Evidenca: <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 9 Udhëzues për hartimin e temës së diplomës;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët kanë mundësi të përdorin kapacitetet dhe infrastrukturën e UMT, për arsye kërkimore. Kjo u konfirmua në takimet në institucion me Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë si dhe me studentët. Evidenca: <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentin vlerësohet me notë.	Në përfundim të punimit të diplomës, studentët vlerësohen me notë. Evidenca: <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore; Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri".</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria	Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës (neni 52, pika 7 e Rregullores së Njesisë Kryesore dhe neni 14 i Rregullores së programit të studimit).

përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Së bashku me diplomën studenti merr listën e notave dhe suplementin e diplomës. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Evidenca: <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri"</i> <i>Evidenca 22 Format diplome MSc</i> <i>Evidenca 22. 1 Suplement MSc Infermieri 20-23.</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet sipas legjislacionit në fuqi. Informacioni mbi studentët (regjistri themeltar, regjistri i arritjeve akademike) ju vu GVJ në dispozicion nga sekretaria mësimore. Evidenca: <i>Evidenca 164 Rregullore e sekretarise mesimore;</i> <i>Takim me sekretarinë mësimore.</i>			
Konkluzione	<i>Procesi i diplomimit realizohet me anë të punimit të diplomes. Në përfundim të programit të studimit studenti pajiset me diplomën: Diplomë e ciklit të dytë "Master i Shkencave në Infermieri". Të gjitha rregulloret e institucionit, lista e temave të diplomës, njoftimet në lidhje me workshop-e dhe orë të hapura ku studentët do të ndihmohen në orientimin e kërkimit shkencor bëhen publike. Në përfundim të punimit të diplomës, studentët vlerësohen me notë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Me qëllim formimin e studentëve, UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit. Në bazë të akteve ligjore, Spitalet Universitare janë në funksion të formimit të specialistëve të shëndetësisë, përfshirë ketu dhe programin Msc në Infermieri. Kjo gjë garanton formim profesional të studentëve. Evidenca: <i>Evidenca 144 VKM Për miratimin e strukturave shëndetësore universitare;</i> <i>Evidenca 79; 79.1 Raporti Vjetor UMT</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT</i> <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP</i> <i>Evidenca 101 Lista e bashkëpunime me institucione të tjera FSHMT; Vizita në ambientet e Institucionit.</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	UMT për implementimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Infermieri” bashkëpunon me Spitalet Universitare. Pranë këtyre strukturave, studentët kanë mundësinë të zhvillojnë praktikën mësimore me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të tyre. Studentët kanë mundësinë në këto spitale të përdorin teknologjinë egzistuese me qëllim rritjen e njohurive dhe kompetencave profesionale. Evidenca: <i>Evidenca 144 VKM Për miratimin e strukturave shëndetësore universitare;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen	Praktika profesionale është e parashikuar në Programin e studimit Master i Shkencave në “Infermieri” dhe ka 26 kredite (12 kredite praktikë profesionale dhe 14 kredite praktikë lëndore). Pedagogu u lëndës respektive së bashku me

në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	mbikqyrësin e praktikës vendosin notën. Në takimet në institucion, kjo procedurë u konfirmua.			
	Evidenca: <i>Evidenca 91 Plani mesimor MSc. Infermieri 23-26;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>			
Konkluzione	<i>Me qëllim formimin e studentëve, UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda vendit. Në bazë të akteve ligjore, Spitalet Universitare janë në funksion të formimit të specialistëve të shëndetësisë, përfshirë ketu dhe programin Msc në Infermieri. Kjo gjë garanton formim profesional të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në	Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Msc në "Infermieri" plotëson të gjitha kriteret që përcaktohet në LAL. Nga shyrtimi i dokumentacionit

realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

të vënë në dispozicion, rezulton se stafi akademik për programin e studimit ka kualifikimin si më poshtë vijon:

Grada/tituj	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	3	-	3	-	2	-
Prof.Asoc.	5	-	5	-	5	-
Dr./PhD	17	9	17	7	17	8
MSc (Dr. në proces)	1	-	2	-	2	-
Msc	-	-	-	-	-	-
Total	26	9	27	7	26	8

Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përgjithësisht përmbush kërkesat ligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë, nr. 80, 2015, neni 59) për nivelin e kualifikimit (PAE dhe PAK që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi) në lidhje me gradat shkencore.

Ligji kërkon që personeli akademik të ketë të paktën gradën Doktor, edhe pse në këtë program studimi janë angazhuar personel akademik me Msc, (5%), megjithatë aktualisht janë në proces Doktorature. (përkatësisht 1 PAE për vitin akademik 2021-2022; 2 PAE për vitin akademik 2022-2023, dhe 2 PAE për vitin akademik 2023-2024).

Evidenca:

RVB- MSH në Infermieri;

Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor i DLKIPISBP

Evidenca 80; 81; 82 Raporti vjetor i FSHMT

Evidenca 97 Tabela përmbledhëse

Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë;

Vizita në ambientet e FSHMT

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit (*Evidenca 97. Tabela përmbledhëse Ascal Bsc në Infermieri, tab 12.2, 12.3*) u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për dy vitet e fundit është si më poshtë vijon:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2022-2023	1947	872	1072	44% / 56%
2023-2024	1926	788	1138	41% / 59%

Nga sa më sipër rezulton që për të dy vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, nuk është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.

GVJ rekomandon që përballimi i ngarkesës mësimore për programin e studimit Master i Shkencave në “Infermieri” duhet të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.

Evidenca:

Evidenca 92. Syllabuset Master Shkencor në Infermieri

Evidenca 96. CV të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit

Evidenca 97. Tabela përmbledhëse Ascal MSc Infermieri

Takim me Drejtuesin e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me

Referuar informacionit që na është paraqitur në RVB, bashkangjitur edhe dokumentacioneve shoqëruese, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Shumica e këtij stafi akademik e kanë nisur karrierën e tyre në këtë fakultet edhe kanë avancuar dukshëm falë edhe politikave mbështetëse nga ana e fakultetit, të cilat i kanë ndihmuar në promovimin e tyre.

sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit gjatë 3 viteve të fundit nuk ka patur ndryshime të mëdha. Kjo vërehet në listën e PAE të tre viteve të fundit, por edhe në kontratat e punës të lidhura midis personelit akademik dhe institucionit, të cilat kanë të parashikuara mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga institucioni sipas ligjeve në fuqi. Evidenca: <i>RVB- MSH në Infermieri;</i> <i>Evidenca 157.Model kontrate personel administrative</i> <i>Evidenca 158.Model kontrate personel ndihmes akademik</i> <i>Evidenca 159.Model kontrate pedagoget e jashtem.</i> <i>Evidenca 160.Model kontrate personel akademik</i> <i>Evidenca 97. Tabela permbledhese Ascal MSc Infermieri</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë, takim me stafin</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek procedurë rekrutimi të mirëpërcaktuar në rregulloren e burimeve njerëzore, ku përcaktohet qartë procedura e punësimit, që nga kërkesa për personel akademik efektiv, nga njësia bazë drejt njësisë kryesore, e më pas drejt Rektorit. Në kërkesat për punësim, përcaktohen edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kualifikimin profesional dhe akademik. GVJ verifikoi në mënyrë rastësore dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe staf i ri akademik me kontratë, dhe u konstatua se dosjet e personelit nuk kishin mangësi në plotësimin e tyre. Dosjet e pedagogëve ishin të azhornuara me punimet e tyre në revista apo konferenca dhe me trajnimet apo ëorkshopet e realizuara nga stafi. <u><i>GVJ rekomandon unifikimin e CV sipas të njëjtit format</i></u> Evidenca: <i>RVB- MSH në Infermieri;</i> <i>Evidenca 96.CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit</i> <i>Evidenca 163. Praktikë e punësimit të personelit akademik në department</i>

	<i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë, takim me përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës;</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, u evidentua angazhimi i personelit ndihmës akademik, ata asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirëmbajtjen e laboratorëve. Në tre vite akademike në rang fakulteti personeli ndihmës akademik është si më poshtë vijon: 2020 – 2021 9 personel ndihmës akademik; 2021– 2022 9 personel ndihmës akademik; 2022 – 2023 9 personel ndihmës akademik; Personeli ndihmës akademik është i mjaftueshëm dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij. Evidenca: <i>Evidenca 83.Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2023</i> <i>Evidenca 84.Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2022</i> <i>Evidenca 85.Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2021</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë bazë</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	UMT, nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Në tabelat përmbledhëse, si dhe në dosjet e vëzhguara fizikisht në institucion, të dhënat përfshijnë anëtarët e personelit akademik të angazhuar në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. Në cdo fillim viti akademik anëtarët e stafit përditësojnë dosjet e tyre, pas lajmërimeve të bëra. E më pas këto të dhëna përdoren për të përpiluar raporte, analiza vjetore, apo performancën vjetore. Evidenca: <i>Evidenca 2.Rregullore e Universitetit të Mjekësisë Tirane</i> <i>Evidenca 79; 79.1 Raporti Vjetor UMT</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT</i>

	<i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë, takim me përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Gjatë vizitës që GVJ zhvilloi në institucion konstatoi dhe ju vunë në dispozicion marrëveshje të bashkëpunimit me institucione të tjera, sipas referencave përkatëse. Studentët zhvillojnë praktikën mësimore dhe lëndore në laboratorët që FSHMT ka në dispozicion si edhe në QSUT, apo edhe spitalet e tjera me të cilat kanë marrëveshje. Por këto marrëveshje ishin të shtrira edhe në insitucione të arsimit të lartë, kombëtare e ndërkombëtare. Nga institucioni raportohet se stafi mbikqyrës për praktikën profesionale janë staf i spitaleve universitare. Evidenca: <i>Evidenca 46,47,48,49 Marrëveshje bashkëpunimi të ndryshme</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT</i> <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP</i> <i>Evidenca 101. Lista e bashkëpunimeve me insitucione të tjera FSHMT</i> <i>Takim me stafin</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në rregulloren e FSHMT, saktësisht neni 33, është i përcaktuar qartësisht cili është roli dhe cilat janë detyrimet e drejtuesit të praktikës. DLKIPISBP ka 85 mbikqyrës së praktikës profesionale (mentorë) dhe ka tre laborantë. Për mbikqyrjen dhe mbarëvatjen e praktikave profesionale, FSHMT ka përgatitur dhe Ditarin e Praktikave Profesionale që bën të mundur ndjekjen dhe vlerësimin e studentit, një praktikë kjo e cila duhet përgëzuar. <i>Nga institucioni raportohet që stafi mbikqyrës i praktikës profesionale janë staf i spitaleve universitare.</i> Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 97 Tabela permbledhese;</i> <i>Evidenca 13.1; 13.2; 13.3 Ditar i praktike</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>

Konkluzione	<i>Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në këtë program studimi, plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i arsimit të Lartë për nivelin e duhur profesional për natyrën dhe modulet e këtij programi.</i> <i>Jo i gjithë personeli akademik, që angazhohet në këtë program studimi, plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i arsimit të Lartë për të dhënë mësim në IAL për nivelin e duhur të kualifikimit akademik për natyrën dhe modulet e këtij programi. Në këtë program studimi janë angazhuar personel akademik me Msc, (5%), megjithatë aktualisht janë në proces Doktorature. (përkatësisht 1 PAE për vitin akademik 2021-2022; 2 PAE për vitin akademik 2022-2023, dhe 2 PAE për vitin akademik 2023-2024).</i> <i>Ngarkesa mësimore e këtij programi nuk mbulohet me PAE në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. GJVJ rekomandon që përballimi i ngarkesës mësimore për programin e studimit Master i Shkencave në "Infermieri" duhet të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të	GVJ gjatë vizitës që zhvilloi në FSHMT vuri re se ky Institucion me të dy godinat që kishte në dispozicion ka hapësirat e nevojshme dhe të duhura për zhvillimin sa më bashkëkohor të programit mësimor si: Sallat e leksioneve, të seminareve, laboratorët, etj, të cilat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboreve dhe orëve praktike. <i>Evidenca:</i>

programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik. Sallat e leksionit janë të pajisura me projektorë që mundësojnë demonstrimin me video të leksioneve të ndryshme. Personeli akademik ka kompjuter personal me lidhje internet, që bën të mundur edhe zbatimin e metodave të mësimdhënies në distancë. Numri 12 i laboratorëve, ku 7 prej tyre ishin të realizuar në vitet e fundit, janë një e dhënë mjaft e rëndësishme në plotësimin e nevojave mësimdhënëse e mësimnxënëse të studentëve. Evidenca: <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Laboratorët klinikë të kompletuar në Histologji, Mikrobiologji, përbëjnë një bazë të konsiderueshme në funksion të programeve të FSHMT dhe projekteve kërkimore të studentëve. Labororet e Infermieristikës janë imitim i një dhome spitali që përmbajnë mjete, mulazhe total body dhe të pjesshëm me dhe pa simulim, aparatura bashkëkohore të monitorimit dhe mjekimit të pacientit si monitor, sfigmomanometër, termometër, oksimetër, shiringa të përmasave të ndryshme dhe shiringa elektrike, pompa perfuzioni, kateter venoz periferik të përmasave të ndryshme, kateter venoz etj. Këto laborete pajisen vazhdimisht si me mjete të konsumit ashtu edhe me aparatura të reja sipas kërkesave të stafit dhe departamentit. Duhet të përmendim 2 laborete moderne të ndërtuar në bashkëpunim me HAP, me manekina simulatore. Evidenca: <i>Evidenca 117.Laboratori I Infermieristikës</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së	FSHMT ka në përbërjen e tij një laborator dedikuar teknologjisë dhe aplikimit në fushën e mjekësisë, vecanërisht atë të imazherisë. Numri i konsiderueshëm i kompjuterave në dispozicion të studentëve si edhe mbulimi me ëifi janë dëshmi e

informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	përmirësimit të teknologjisë, gjë që u vjen në ndihmë stafit dhe studentëve. Evidenca: <i>Evidenca 118. Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, UMT</i>			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se FSHMT disponon mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatura me fushën e programit të studimit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ duke u bazuar në dokumentacionet e vëna në dispozicion, vizitën në institucion, në bibliotekë, takimin me drejtuesit e njësive bazë edhe asaj qëndrore, stafin dhe studentët u informua se, studentët dhe stafi kanë në dispozicion tekste fizike dhe on-line. <i>GVJ rekomandon përditësim të literaturës, pasi kërkesa e fundit e bërë për pasurimin e bibliotekës ishte në vitin 2018, referuar dokumentacione të dorëzuara.</i> Drejtuesit e Njësive Kryesore/Bazë na informuan që mospërditësimi i disa prej teksteve ka ndodhur edhe pasi tanimë shumë prej pedagogëve përdorin edhe libra online. Ndërkohë që gjatë takimit me studentët ata pohuan se e frekuentojnë bibliotekën. Nga vizita nga vizita në bibliotekë rezultoi se ajo ishte e pajisur, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Evidenca: <i>Evidenca 92 Silabuset Master Shkencor infermieri;</i>

	<i>Evidenca 113 Biblioteka FSHMT;</i> <i>Evidenca 114 Bibliotekat online - lista dhe pershkrim;</i> <i>Evidenca 24 Udhezues biblioteka online;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;takim me studentët</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ, bazuar në dokumentacionet e paraqitura por edhe gjatë bisedimeve në ditët e vizitës në institucion evidentoi që literatura e paraqitur ka nevojë për përditësim. Bashkëbisedimi me drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe asaj Bazë na informoi që mospërditësimi i disa prej teksteve ka ndodhur edhe pasi tanimë shumë prej pedagogëve përdorin edhe libra online. <u><i>GVJ rekomandon përditësim të literaturës me botime të viteve të fundit.</i></u> Evidenca: <i>Evidenca 92. Silabuset Master Shkencor infermieri;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se FSHMT vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën mësimore. Biblioteka është në dispozicion të stafit dhe studentëve në mënyrë të barabartë. Biblioteka ka një rregullore të brendshme që respektohet me seriozitet për sa i përket mënyrës së tërheqjes, shfrytëzimit dhe trajtimit të librave. Studentët mund të shfrytëzojnë gjithë fondin e bibliotekës. Evidenca: <i>Evidenca 24. Udhezues biblioteka online;</i> <i>Evidenca 113. Biblioteka FSHMT;</i> <i>Evidenca 114. Bibliotekat online - lista dhe pershkrim;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;takim me studentët</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me stafin e bibliotekës u informua se fondi i librave të bibliotekës dhe salla e leximit ndodheshin në të njëjtin ambient me një kapacitet prej 138 vende leximi.

shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në bibliotekë, nëpërmjet kompjuterave që ndodhen aty, studentët mundën të përdorin edhe libraritë online që ofron UMT. Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtë shfrytëzimin jo vetëm të literaturës fizike, por edhe atë on-line, për realizimin sa më të mirë të procesit mësimor dhe moduleve të programit Master shkencor. GVJ konstatoi se librat ishin të klasifikuar sipas profileve, por kishte nevojë të plotësohej me tituj dhe botime të reja, edhe pse punonjësit e bibliotekës na informuan edhe përdorimin e gjerë që kishte biblioteka online. Evidenca: <i>Evidenca 24 Udhezues biblioteka online;</i> <i>Evidenca 113 Biblioteka FSHMT;</i> <i>Evidenca 114 Bibliotekat online - lista dhe pershkrim;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik; takim me studentët</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ konstatoi se aksesit për studentët në bibliotekat online sigurohet falas nga fakulteti ose universiteti. HINARI, TELEMEDICINE apo Albanian Health Foundation, janë disa prej librarive online ku si studentët edhe stafi kanë akses. Evidenca: <i>Evidenca 24 Udhezues biblioteka online;</i> <i>Evidenca 114 Bibliotekat online - lista dhe pershkrim;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik; takim me studentët</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ nga vizita në institucion konstatoi se biblioteka ofron mundësi kërkimi të informacionit në sallën e leximit dhe pranë kompjuterave të sallës. Biblioteka elektronike është pjesë e telemjekësisë, e cila është në shërbim të studentëve dhe stafit të UMT. Evidenca: <i>Evidenca 146. Shërbimi i telemjekësisë</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>

	<i>Takim me stafin akademik; takim me studentët</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstatoi se biblioteka në FSHMT konsiderohej si një mjedis multifunksional ku studentët kryejnë aktivitete të ndryshme, takime apo diskutime në lidhje me projektet e tyre. Biblioteka ndodhej në katin e pestë të godinës dhe e aksesueshme prej studentëve nga ora 8-16. Evidenca: <i>Evidenca 113 Biblioteka FSHMT;</i> <i>Rregullore e FSHMT, neni 39</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik; takim me studentët</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka funksiononte në bazë të një rregulloreje ku çdo gjë dokumentohej në bazë të kartelave për studentë dhe për staf. Orientimi i studentëve për përzgjedhjen e literaturës në përgjithësi bëhej nga stafi akademik. Vitet e fundit FSHMT ka qenë e orientuar në investime për përmirësimin e infrastrukturës së bibliotekës elektronike, duke qenë se edhe pas pandemisë COVID 19 u rrit ndjeshëm përdorimin i informacionit dixhital kundrejt atij fizik. Bazuar edhe në evidencat përkatëse por edhe nga komunikimet gjatë vizitë. Departamenti bën propozimet përkatëse për fondin e bibliotekës dhe përditësimin e literaturës. Por edhe vetë Biblioteka bazuar në kërkesat e stafit edhe studentëve parashtron kërkesat e saj drejtuar administratorit të fakultetit, për vënie në dispozicion të botimeve të reja apo abonime online. Evidenca: <i>Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT</i> <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP</i> <i>Takim me stafin dhe studentët</i>
Konkluzione	<i>FSHMT ka një bibliotekë universitare me hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët.</i> <i>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. FSHMT ka krijuar kushte për</i>

	<i>shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line.</i> <i>Oraret e shërbimit të bibliotekës janë tek rregullore e bibliotekës, orare janë të përshtatje me oraret e programit të studimit nevojat e studentëve. Literatura mjekësore ne biblioteke është e pasur, por <u>GVJ rekomandon</u> përditësim të literaturës me botime të viteve të fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	FSHMT ka sistem menaxhimi të brendshëm për administrimin e informacionit që lidh studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Easy Ëeb është platforma kryesore e institucionit (UMT), e cila përfshin administrimin e aktivitetit akademik, mësimor dhe trajnues. PITAGORA është aplikacioni i sekretarisë online i zhvilluar nga RASH, i cili ofron funksionalitete për sekretarinë, studentët dhe pedagogët për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve, si dhe regjistri themeltar sipas formatit të miratuar nga MAS. Evidenca: <i>Evidence 36. Platforma e UMT VSA</i> <i>Evidenca 40.Ndërfaqe sistemi PITAGORA</i> <i>Evidenca 42.Ndërfaqe Easy Ëeb (për lëndën)</i> <i>Evidenca 149.përshkrim I funksionaliteteve të sistemit PITAGORA</i> <i>Evidence 150. Përmbledhje manual Easy Ëeb</i> <i>Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimore</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Zyra e Burimeve Njerëzore në FSHMT, administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. UMT nëpërmjet sistemit PITAGORA, një sistem i konsoliduar tanimë prej 2020-2021, mundëson, përveç shërbimeve të sekretarisë, edhe menaxhimin e detyrimeve akademike të studentëve. Gjithashtu duhet të nënvizojmë edhe sistemin GRADUA, i cili është sistemi i regjistrimit të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve, mjaft efektiv në gjurmimin e studentëve dhe statusit të punësimit të tyre. Krahas kësaj një arritje e UMT është edhe ndërtimi i systemit të përzgjedhjes së maturantëve që aplikojnë në programet e UMT. Evidenca: <i>Evidenca 40. Ndërfaqe sistemi PITAGORA</i> <i>Evidenca 41. Ndërfaqe UMED</i> <i>Evidenca 43. Ndërfaqe Sistem elektronik I dedikuar për pikëzimin dhe renditjen e aplikantëve</i> <i>Evidenca 141. Ndërfaqe ASCAL AMS</i> <i>Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimore</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	FSHMT disponon infastrukturën e duhur për një edukim në distancë. Këtë infrastrukturë e përdorte dhe për informimin e studentëve në lidhje me veprimtari, takime, mbledhje, diskutime, kërkim shkencor, mobilitete, etj. FSHMT kishte pajisur gjithë studentët dhe stafin me email personale të institucionit me domain@umed.edu.al që bënë të mundur njoftimet në kohë reale. Evidenca: <i>Evidenca 40. Ndërfaqe sistemi PITAGORA</i> <i>Evidenca 20. Emaille zyrtare</i> <i>Evidenca 142. Pr.sc të shërbimeve të RASH</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton	FSHMT, ashtu sikurse gjithë UMT, ka faqen e vet zyrtare e cila ka rëndësi të madhe në komunikim dhe informim. Npm faqes



monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	zyrtare pasqyrohen veprimtaritë akademike dhe institucionale, administrative, kulturore e sociale, informacione që lidhen me dokumentacione kryesore të UMT dhe FSHMT, vendime të Senatit Akademik dhe Dekanatit etj. Ndërsa për komunikim të brendshëm stafi përdor emailet zyrtare, google classroom, google site, si për stafin akademik ashtu edhe për studentin. Falë Zyrës së IT bëhej e mundur mirëmbajtja e sistemit duke bërë të mundur përdorimin në çdo kohë, si edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit. Evidenca: <i>Evidence 23. Shembull ndërfaqe google classroom</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin dhe studentët</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	FSHMT zotëron një faqe ëeb aktive, që mund të aksesohet nga çdo njeri. Kjo faqe është dinamike dhe përveç informacioneve të ndryshme, publikon në mënyrë periodike aktivitetin fakultetit, të departamenteve dhe njësive të tjera. Gjithashtu edhe rrjete sociale janë një mënyrë komunikimi në FSHMT, mjaft të përdorura këto nga ana e studentëve. <u>GVJ sygjeron që publikimet në këtë faqe të bëhen edhe në gjuhën angleze.</u> Evidenca; <i>Evidenca 12. Ndërfaqe facebook-FSHMT</i> <i>Evidenca 168. Ndërfaqe interneti FSHMT</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin dhe studentët</i>
Konkluzione	<i>FSHMT disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit institucional, i cili siguron akses të dedikuar, në informacione e dokumente, për studentët dhe pedagogët. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik. Nëpërmjet këtij sistemi përfshihet edhe komunikimi interaktiv dhe shkëmbimi i informacioneve.</i> <i>FSHMT disponon faqen zyrtare, ku studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të marrin informacione për programet dhe për aktivitetin akademik të FSHMT.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ bazuar në evidencat përkatëse, por edhe gjatë vizitës 2-ditore në institucion evidentoi se FSHMT harton raportin vjetor, raport ky mjaft i rëndësishëm për informacion që përfshin. Ky raport përfshinte aktivitetet e brendshme dhe të jashtme të DLKIPISBP, shpenzimet, të ardhurat, infrastrukturën, të dhëna për programin e Masterit Skencor dhe numrin e studentëve. Raporti vjetor përmbledh analizën vjetore të cdo njësie bazë, njësie kryesore e administrative në UMT. Evidenca: <i>Evidenca 79.1 Raporti vjetor UMT 2021-2022</i> <i>Evidenca 79. Raporti vjetor UMT 2020-2021</i> <i>Evidenca 80. Raporti vjetor FSHMT 2020-2021</i> <i>Evidenca 81. Raporti vjetor FSHMT 2021-2022</i> <i>Evidenca 82. Raporti vjetor FSHMT 2023</i> <i>Evidenca 83. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2023</i> <i>Evidenca 110. Analiza vjetore zyra e finances</i>

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Në FSHMT, përgatitja e buxhetit, mënyra e shpërndarjes së fondeve dhe përdorimit të tyre, është kompetencë e institucionit dhe menaxhohet nga Bordi i Administrimit. FSHMT gjeneronte të ardhura nga studentët, projektet, etj. Shpërndarja financiare realizohej sipas nevojave që kanë njësitë bazë. Propozimet vinin nga baza dhe miratimi i tyre bëhej nga Rektorati. Proçesi i hartimit të buxhetit nis me diskutimet dhe marrjen e propozimeve nga njësitë bazë dhe strukturat administrative. Pas shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve, fakulteti përcjell planin në nivel fakulteti në Rektorat. Në planin e financimit përfshiheshin zëra për: burimet njerëzore dhe infrastrukture, materialet e konsumit dhe materialet për laboratore, pajisjet, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimin e bibliotekës, mundësitë e mbështetjes financiare në fushën e kërkimit shkencor për stafin akademik, në projekte ndërkombëtare Evidenca: <i>Evidenca 2. Rregullore e UMT</i> <i>Evidenca 51. Praktikë e ndjekur për auditim nga Nësia e auditimit të brendshëm</i> <i>Evidenca 52. Praktikë për miratimit e buxhetit vjetor UMT</i> <i>Evidenca 53. Propozim për buxhetin vjetor të departamentit</i> <i>Evidenca 88. Të dhëna financiare për alokim buxheti FSHMT dhe mobilitete.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Bazuar në dokumentacionet e sjella, NJAB (Njësia e Auditimit të Brendshëm) është struktura e ngritur në nivel universiteti për të kryer auditimin periodik. NJAB ushtron veprimtari të pavarur, dhe në mënyrë sistematike ndihmon në vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të menaxhimit të brendshëm të institucionit. Kështu FSHMT në përbërje të së cilës është edhe DLKIPISBP, si pjesë përbërëse e UMT, kryejnë veprimtarinë e tyre financiare në përputhje me planet e miratuara nga Rektorati. Evidenca: <i>Evidenca 50. Praktikë e ndjekur për auditim nga njësi audituese e jashtme (UNICEF)</i>

	<i>Evidenca 51. Praktikë e ndjekur për auditim nga Nësia e auditimit të brendshëm</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UMT dhe FSHMT tanimë kanë eksperiencën e nevojshme në kryerjen, hartimin dhe raportimin e cdo veprimtarie që zhvillojnë. Sistemi i menaxhimit ka bërë të mundur që një proces i tillë të realizohet në kohë reale. Raporti vjetor është dokumenti që përmbledh veprimtarinë akademike, financiare dhe shkencore. Gjatë takimit me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe me Drejtuesin e Njesisë Bazë na u shpjeguan qartësisht etapat që ndiqeshin deri në hartimin final të Raportit Vjetor, ashtu sikurse ishte paraqitur edhe në dokumentacionet e dorëzuara. Evidenca: <i>Evidenca 79.1 Raporti vjetor UMT 2021-2022</i> <i>Evidenca 79. Raporti vjetor UMT 2020-2021</i> <i>Evidenca 80. Raporti vjetor FSHMT 2020-2021</i> <i>Evidenca 81. Raporti vjetor FSHMT 2021-2022</i> <i>Evidenca 82. Raporti vjetor FSHMT 2023</i> <i>Evidenca 83. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2023</i> <i>Evidenca 110. Analiza vjetore zyra e finances</i> <i>Takim me drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	GVJ bazuar në RVB, referencat përkatëse si dhe takimin me drejtuesit e institucionit konstaton se institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Të ardhurat siguroheshin kryesisht nga tarifat e shkollimit, tarifa regjistrimi, të ardhura nga projekte etj. Gjithashtu UMT vendos lidhjen e marrëveshjeve të pavarura me institucione private edhe shtetërore. Evidenca; <i>Evidenca 52. Praktikë për miratimit e buxhetit vjetor UMT</i> <i>Evidenca 88. Të dhëna financiare për alokim buxheti FSHMT</i> <i>Takim me drejtuesin e njësisë bazë dhe njësisë kryesore</i>

Konkluzione	<i>UMT dhe FSHMT garantojnë financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri" dhe mbështetjen e studentëve.</i> <i>Çdo vit akademik FSHMT harton raportin financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit.</i> <i>UMT garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, studentët, sekretarinë mësimore, RVB, konstatoi se ky institucion harton politika dhe procedura të sakta gjatë vitit akademik të studentëve (në hyrje dhe në përfundim të studimeve), në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi. Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e universitetit. Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë

	studentët. Mundësohet ndjekja korrekte e kandidatit që nga momenti i aplikimit deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Çdo student që paraqet kërkesë për transferim për largim apo kalim në FSHMT ka të drejtë ta realizojë këtë në bazë të rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Evidenca: <i>Evidenca 98.1 Tabela me statistikat e studenteve;</i> <i>Evidenca 132.Procedura dhe praktika e pikezimit dhe renditjes së aplikanteve në prog. e ciklit I dhe të integruar;</i> <i>Evidenca 133.Publikimi i kriterëve të pranimit</i> <i>Evidenca 134.Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit I, II, III</i> <i>Evidenca 135 Praktike për miratimin e kriterëve të pranimit cikli i parë dhe integruar;</i> <i>Evidenca 137 Praktike për miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar;</i> <i>Evidenca 139.Procedura për miratimin e kriterëve dhe ekuotave të pranimit në c1, PICD, dhe të ciklit të dytë në UMT.</i> <i>Takim me studentët e të katërt programeve të studimit</i> <i>Takim me drejtuesit e Njesisë Bazë, Njesisë Kryesore</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejtë të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore, GVJ vuri re se UMT dhe FSHMT, ndjekin politika dhe procedura që sigurojnë barazinë bazuar mbi kriteret dhe procedurat për të gjithë kandidatët për t'u regjistruar në Programin e Studimit të Master i Shkencave në "Infermieri". Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore,	GVJ pas shyrimit të RVB, dokumentacioneve të vëna në dispozicion, gjithashtu edhe në takimin me stafin dhe studentet, u informua dhe konstatoi se para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen "ditët e informimit të maturantëve" të cilat përbëjnë burimin kryesor të studentëve që ndjekin studimet në FSHMT, por në vecanti informimin e studentëve të nivelit të bachelor në këtë fakultet të cilët janë

sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	baza e studentëve që regjistrohen në programin e Masterit Shkencor në Infermieri. FSHMT harton dhe publikon përpara çdo viti kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, duke u bazuar në vendimet e Senatit Akademik në mbështetje të kriterëve kombëtare, të propozuara nga njësitë bazë. Programi i Masterit Shkencor në “Infermieri” ofrohet vetëm në gjuhën shqipe, kështu që kuota për studentët e huaj nuk ofrohen. <u>GVJ rekomandon që të krijohet mundësia si fillim për të dhënë lëndë apo module në gjuhë të huaj.</u> Evidenca: <i>Evidenca 98.1 Tabela me statistikat e studenteve;</i> <i>Evidenca 132.Procedura dhe praktika e pikezimit dhe renditjes së aplikanteve ne prog. e ciklit I dhe te integruar;</i> <i>Evidenca 133.Publikimi i kriterëve të pranimit</i> <i>Evidenca 134.Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit I, II, III</i> <i>Evidenca 135 Praktike per miratimin e kriterëve te pranimit cikli i pare dhe integruar;</i> <i>Evidenca 137 Praktike per miratimin e kuotave cikli i pare dhe integruar;</i> <i>Evidenca 139.Procedura për miratimin e kriterëve dh ekuotave të pranimit ne c1, PICD, dhe të ciklit të dytë në UMT.</i> Takim me studentët <i>Takim me drejtuesit e Njesisë Bazë, Njesisë Kryesore</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konstatoi se FSHMT ka një rregullore të veçantë për transferimin e studentëve nga programe të ngjashme dhe ndjekjen e programeve të dyta studimi. Kështu që studentët kanë mundësi të informohen në lidhje me transferimin apo ndjekjen e fakulteteve të dyta. Evidenca: <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP</i> <i>Evidenca 34.Pranimet dhe regjistrimet</i>

	<i>Takim me studentët</i> <i>Takim me drejtuesit e Njesisë Bazë, Njesisë Kryesore</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstatoi se FSHMT, UMT informojnë publikun duke marrë pjesë në Panairët eork & Study të organizuara nga MAS dhe organizojnë orët e hapura për maturantët. Gjithashtu ofrohen informacion me anë fletëpalosjeve, faqes zyrtare ëeb, rrjeteve sociale, etj. Por duhet të pranojmë faktin që deri në këto momente numrat e studentëve të regjistruar në këtë program janë optimalë. Evidenca: <i>Evidenca 12. Ndërfaqe Facebook FSHMT</i> <i>Evidenca 123. Shembull broshure informuese-FSHMT</i> <i>Evidenca 143. Ndërfaqe web UMT</i> <i>Evidenca 168. Ndërfaqe e internetit FSHMT</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se politikat e UMT nuk përbëjnë diskriminim për studentët me përkatësi të ndryshme, dhe në këtë mënyrë sigurohet barazia për të gjithë kandidatët me aftësi të veçanta. UMT planifikon kuota të vecanta, ofron informim dhe mbështetje të vazhdueshme sipas kriterëve të përcaktuara për këto kategori. <i>Por GVJ konstatoi edhe se FSHMT me infrastrukturën që ka vënë në dispozicion, nuk është e përshtatshme për t'u aksesuar nga ana e studentëve me aftësi të kufizuar.</i> Evidenca: <i>Evidenca 98. Praktikë për miratimin e kuotave të ciklit të parë dhe të integruar</i> <i>Evidenca 137. Tabela me statistikat e studentëve</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UMT dhe FSHMT u ofrojnë mundësi studentëve që vijnë nga trojet apo shtetas të huaj për të ndjekur studimet. Nëpërmjet faqes web të UMT, fletë palosjeve, reklamave televizive, Zyrës së Karrierës dhe Këshillimit, ofrohen informacione për mënyrën e ndjekjes së procedurave për regjistrim. UMT publikon kuotat për kategoritë e studentëve nga trojet përpara se sa të fillojë viti akademik bazuar në historikun e këtyre kërkesave nga vitet e mëparshme.

	Evidenca: <i>Evidenca 98.1 Tabela me statistikat e studenteve;</i> <i>Evidenca 132.Procedura dhe praktika e pikezimit dhe renditjes se aplikanteve ne prog. e ciklit I dhe te integruar;</i> <i>Evidenca 133.Publikimi i kriterëve të pranimit</i> <i>Evidenca 135 Praktike per miratimin e kriterëve te pranimit cikli i pare dhe integruar;</i> <i>Evidenca 139.Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit ne c1, PICD, dhe të ciklit të dytë në UMT.</i> Takim me studentët <i>Takim me drejtuesit e Njesisë Bazë, Njesisë Kryesore</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UMT dhe FSHMT në politikat e saj ofron mbështetje financiare për studentët me rezultate të larta, studentët me aftësi të kufizuar, studentët me një prind por edhe për kategori të tjera. Prej vitesh në UMT studiojnë studentë me rezultate shumë të larta, dhe sigurisht ndihma dhe mbështetja financiare, bazuar në procedura të saktësuara në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, ka ndikuar në rritjen e cilësisë së programeve të ofruara, një përparësi kjo jo vetëm për institucionin por edhe për zhvillimin ekonomik të vendit.Gjithashtu GJVJ konstatoi se për shtresat në nevojë institucioni planifikon kuota pranimi duke u bazuar në kërkesat e viteve të mëparshme. Evidenca: <i>Evidenca 1.Statuti i Universitetit të Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidenca 2.Rregullore e Universitetit të Mjekësisë-Tirane</i> <i>Evidenca 130.Politika dhe praktika për fitimin e bursave të studentëve dhe përjashtimi nga tarifa vjetore e studimit</i> <i>Evidenca 132.Procedura dhe praktika e pikezimit dhe renditjes se aplikanteve ne prog. e ciklit I dhe te integruar;</i> <i>Evidenca 133.Publikimi i kriterëve të pranimit</i> <i>Evidenca 135 Praktike per miratimin e kriterëve te pranimit cikli i pare dhe integruar;</i> <i>Evidenca 139.Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit ne c1, PICD, dhe të ciklit të dytë në UMT</i>

Konkluzione	<i>UMT dhe FSHMT ndjekin dhe zbatojnë politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit bazuar në aktet ligjore.</i> <i>UMT, ndjek politikë mbështetëse për studentët e shtresave në nevojë duke i ndihmuar ekonomikisht si edhe për dhe studentët me nevoja dhe statuse të veçanta ofron lehtësira financiare të cilat parashikohen në kontratat individuale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ, referuar takimit të zhvilluar me përfaqësues të institucionit, dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të web, konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjithashtu u konstatua se studentët informoheshin nga Zyra e Karrierës, (edhe pse duhet punuar akoma më shumë në këtë drejtim për informimin e studentëve), përgjegjësi i programit të studimit dhe senatori i vitit përkatës në lidhje me rregulloret e shkollës, rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit, pikëzimet, etj. Studentët gjithashtu informoheshin në orët e para të çdo leksioni lidhur me të gjithë elementët e përshkruar në syllabuset e lëndëve që zhvillojnë në Master i Shkencave në Infermieri. Evidenca: <i>Evidenca 21. Rregullore FSHMT, programi cikli i dytë, Master Shkencor</i> <i>Evidenca 92. Syllabuset Master Shkencor Infermieri</i>

	<i>Takim me të gjitha nivelet e përfaqësuesve të institucionit</i> <i>Takim me studentët dhe pedagogët</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstatoi në nenin 108 të rregullores së Institucionit UMT, ku përcaktohet mundësia e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njesisë Kryesore, në nenet 35 dhe 36 raportohet mbi transferimet e mundshme si dhe njohjeve të krediteve. Ndërsa në nenet 46; 47; 48; të Rregullores së Departamentit përmendet Njohja dhe Ekuivalentimi i studimeve, diplomave dhe kalimit nga një program studimi në një tjetër. Në rregulloren e programit të studimit neni 10 përcakton kriteret e regjistrimit, ndërkohë që nuk kemi një specifikim të procedurës së transferimit. Gjithashtu në nenin 31 dhe 32 të Rregullores së Njesisë Kryesore përcaktohet shkëputja dhe ndërprerja e studimeve. Kriteret e pranimi dhe kuotat për këtë program studimi miratohen nga Senati Akademik. Evidenca: <i>Evidenca 1 Statuti i UMT;</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Infermieri";</i> <i>Evidenca 98.1 Tabela me statistikat e studenteve;</i> <i>Evidenca 132.Procedura dhe praktika e pikezimit dhe renditjes së aplikanteve në prog. e ciklit I dhe të integruar;</i> <i>Evidenca 133 Publikimi i kriterëve të pranimi - ciklit i parë dhe PICD;</i> <i>Evidenca 135 Praktike për miratimin e kriterëve të pranimi ciklit i parë dhe integruar;</i> <i>Evidenca 137 Praktike për miratimin e kuotave ciklit i parë dhe integruar;</i> <i>Evidenca 139 Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimi në c1, PICD dhe të ciklit të dytë në UMT</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive	GVJ konstatoi, nga RVB dhe takimi që pati me studentët gjatë vizitës në institucion, se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara dhe

të studentëve në programin e studimit.	prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimit, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit. Studentët informuan GVJ se në cdo javë të parë te semestrit informohen dhe diskutojnë me pedagogët e lëndëve mbi procedurën e vlerësimit të tyre për cdo lëndë duke u njohur me syllabusin e lëndës. Evidenca: <i>Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 21. Rregullore FSHMT, Program cikli i i Dytë FSHMT, e Masterit Shkencor</i> <i>Evidenca 92. Silabuset Master Shkencor Infermieri</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstatoi se programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” përmbyllet me mbrojtjen e mikrotezës. Në rregulloren e UMT, të Fakultetit, të Departamentit dhe të Programit të Studimit janë të specifikuara të gjitha kushtet dhe procedurat për Projektin e Diplomimit. Departamenti siguron të gjitha kushte për informimin e sqarimin e studentëve për të finalizuar me sukses këtë proces. Evidenca: <i>Evidenca 2 Rregullore e UMT;</i> <i>Evidenca 5 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Mjekesore;</i> <i>Evidenca 6 Rregullore Departamenti DLKIPISBP;</i> <i>Evidenca 21 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Infermieri”;</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstatoi se FSHMT përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike duke marrë pjesë në Panaiet Work & Study të organizuara nga MAS, organizon orët e hapura në institucion për maturantët, dhe për të gjithë studentët e bachelorit për të dhënë të gjitha informacionet e duhura në lidhje me programin e Master i Shkencave në Infermieri. Gjithashtu ofron informacion me anë fletëpalosjeve, faqes zyrtare Web, rrjeteve sociale, etj. Evidenca: <i>Evidenca 86. Programi i studimit në Msc. Infermier i përgjithshëm</i> <i>Evidenca 91. Plani mësimor Msc.Infermier i Përgjithshëm</i>

	<i>Evidenca 133 Publikimi i kriterëve të pranimit - ciklit i parë dhe PICD;</i> <i>Evidenca 139 Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit në c1, PICD dhe të ciklit të dytë në UMT</i> <i>Evidenca 128. Orientimi dhe informimi i maturantëve</i> <i>Evidenca 129. Grupi i punës për informimin e maturantëve.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurave të vlerësimit të dijeve, kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit Msc.në Infermieri. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, FSHMT informon publikun për programet e studimit që ofron duke organizuar takime të hapura me të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit, fletë palosjeve informuese, informacionit në faqen e webit të universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ në bazë të dokumentacioneve të vëna në dispozicion, planet mësimore, rregulloret, statutit, takimeve me drejtuesit e institucionit, sekretarine mësimore, studentët, konstatoi se, FSHMT vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që i pret në institucion në momentin që interesohen për programet e studimit, nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Sekretarisë Mësimore, senatorëve të grupeve të studentëve aktualë, si dhe

	vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit. Evidenca: <i>Takimi me studentët; stafin akademik; sekretarinë mësimore;</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ duke u bazuar në takimin me drejtues të institucionit, takimin me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimin me studentët mendon se: FSHMT informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit në “Master i Shkencave në Infermieri”. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet ëeb-it. Po ashtu në orën e parë studentët marrin info të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodet e lëndëve, raporti leksion/ seminar/ laborator/ praktik, temat, literatura bazë dhe literatura e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), informacion rreth mbrojtjes së diplomës etj.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	FSHMT ka vendosur në dispozicion të studentëve Zyrën e Këshillimit të Karrierës për studentët që kanë paqartësi në lidhje me orientimin apo mundësitë e punësimit. Kjo zyrë si në UMT ashtu edhe në FSHMT, së bashku me departamentin, janë përgjegjëse për cdo informim për të cilin ka nevojë studenti. Krahas këtyre strukturave GVJ evidentoi se rol të rëndësishëm në procesin e informimit mbi mundësitë e punësimit luajnë edhe këshillat studentorë, ku studenët e brezave më të lartë informojnë ata që janë të sapoardhur në fakultet. Evidenca: <i>Evidenca 107. Manuali i Këshillimit të Karrierës</i> <i>Evidenca 108. Aktiviteti I Zyrës së Karrierës</i> <i>Evidenca 124. Lista e aktiviteteve të Këshillave Studentorë</i> <i>Evidenca 127. Statuti I Këshillave Studentorë</i> <i>Takim me Drejtuesit e Institucionit, takim me studentët</i>

Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidentoj që studentët informohen hollësisht dhe gjerësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar që nga shpjegimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spitale. Studentët në fillim të cdo viti akademik bëhen pjesë e ditëve të hapura, ku cdo zyrë e institucionit është në dispozicionin e tyre, për t'i këshilluar. Evidenca <i>Evidenca 40.Nderfaqe sistemi PITAGORA.</i> <i>Evidenca 128.Orientimi dhe informimi i maturanteve</i> <i>Evidenca 150.Permbledhje Manuale Easyëeb</i> <i>Takim me studentët</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstatoi se FSHMT informon studentët nëpërmjet platformës së brendshme elektronike të komunikimit, Pitagora. Studentët kanë akses në këtë platformë nga cdo ambjent ku ata ndodhen. Evidenca: <i>Evidenca 40.Nderfaqe sistemi PITAGORA.</i> <i>Takim me studentët</i>			
Konkluzione	<i>FSHMT u siguron studentëve infrastrukturën e nevojshme për marrjen e informacionit të hollësishëm lidhur me organizimin e programit të studimit, Master i Shkencave në Infermieri, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale, literaturën e nevojshme dhe strukturat ndihmëse. Institucioni mundëson përfshirjen e studenteve në një sërë aktivitete informuese.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UMT mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Sekretaria mësimore mbante informacion në lidhje me studentët e regjistruar duke ju referuar udhëzimeve të MAS dhe QSHA, në formë fizike dhe elektronike. Evidenca; <i>Evidenca 83. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2023</i> <i>Evidenca 84. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2022</i> <i>Evidenca 85. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2021</i> <i>Evidenca 108.1. Aktiviteti i zyres se karrieres.</i> <i>Evidenca 108. Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT</i> <i>Evidenca 109. Analize vjetore sekretaria mesimore</i> <i>Takim me drejtuesin e Njesisë Kryesore, drejtuesin e Njesisë Bazë, sekretarinë mësimore.</i>																
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës në FSHMT, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Të regjistruar</th><th>Ç’regjistruar</th><th>Totali</th></tr><tr><td>2021-2022</td><td>90 studentë</td><td>3</td><td>87</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>107 studentë</td><td>2</td><td>105</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>117 studentë</td><td>-</td><td>117</td></tr></table>	Viti akademik	Të regjistruar	Ç’regjistruar	Totali	2021-2022	90 studentë	3	87	2022-2023	107 studentë	2	105	2023-2024	117 studentë	-	117
Viti akademik	Të regjistruar	Ç’regjistruar	Totali														
2021-2022	90 studentë	3	87														
2022-2023	107 studentë	2	105														
2023-2024	117 studentë	-	117														

	Evidenca; <i>Takim me sekretarinë mësimore.</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të FSHMT dhe UMT. Në sekretarinë mësimore ndodhej i gjithë dokumentacioni i duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. I gjithë informacioni ruhej në formë fizike po ashtu dhe në formë elektronike të një sistemi të brendshëm të sigurt dhe të verifikueshëm nga persona të autorizuar. Evidenca: <i>Evidenca 2.Rregullore e Universitetit te Mjekesise Tirane</i> <i>Evidenca 150.Permbledhje Manuale Easyweb</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	NJAB është strukturë e posacme e cila mbikqyr, vlerëson dhe garanton autonominë e institucionit. Kjo njësi n.p.m. një plani vjetor pune të miratuar nga titullari i institucionit, ushtron kontrole periodike pranë të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit). Sekretaria Mësimore e FSHMT është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ, në nivel institucioni e cila zhvillon veprimtarinë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Nga vizita që patëm në zyrat e sekretarisë, GVJ konstatoi se regjistrat ishin të përpiluar në mënyrë korrekte pa ndërhyrje apo korrigjime. Evidenca; <i>Evidenca 51. Praktika e ndjekur për auditim nga NJAB</i> <i>Evidenca 83, 84, 85 raporti vjetor DLKIPISBP 2023, 2022, 2021</i> <i>Takim me sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e	Referuar RVB-së, Institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje. Politikat që ndjek institucioni kanë bërë që të afrojnë studentët më të mirë nga të gjitha trojet shqiptare. Gjithashtu nga raporti i UISH tregohen edhe rezultatet mjaft pozitive që këta studentë kanë në provimin e shtetit. Por pa harruar gjithashtu

duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	edhe se rreth 97% e këtyre studentëve, referuar dokumentacione të paraqitura, punësohen në kompani prestigjioze. Evidenca: <i>Evidenca 139. Procedura për miratimin e kritereve dhe kuotave të pranimit në c1, PICD dhe të ciklit të dytë në UMT</i> <i>Evidenca 66. Analizë statistikore e të dhënave të kandidatëve që kanë aplikuar në UMT 2021-2022</i> <i>Takim me drejtuesin e Njesisë Kryesore, drejtuesin e Njesisë Bazë, sekretarinë mësimore</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit. Njësia bazë ku realizohet programi i studimit harton raporte analitike, periodike/analiza vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, kalueshmërinë, frekuentimin dhe diplomimin si dhe punësimin të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se FSHMT bazuar në Rregulloren dhe Statutin e UMT dhe FSHMT u mundëson studentëve përfaqësimin në organet vendimmarrëse si në: - Senatin Akademik; - Grupet e RBV; - Këshillat studentor në rang universiteti dhe fakulteti; - NJSBC;



	- Unioni Studentor; Evidenca: <i>Evidenca 1. Statuti I UMT</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e UMT</i> <i>Evidenca 6. Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidenca 124. Lista e aktivitetetve të Këshillit Studentor UMT</i> <i>Evidenca 125. Përbërja e Këshillit Studentor UMT</i> <i>Evidenca 126. Rregullore e zgjedhjeve të Këshillit Studentor</i> <i>Evidenca 127. Statuti I Këshillit Studentor UMT</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se aktualisht FSHMT përfshin studentët në jetën akademike të institucionit. Këshillat studentorë në nivel fakulteti, sentorët në nivel grupi mësimor, mbështetin studentët në çfarëdo lloj problematike. FSHMT përdor sistemin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programit të studimit dhe ciklit të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve realizohet nga zyra e NJSBC dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve i cili u komunikohet organeve drejtuese. Gjithashtu DLKIPISBP mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, senatorëve por edhe vetë pedagogëve që japin mësim në këtë program. Evidenca: <i>Evidenca 1. Statuti I UMT</i> <i>Evidenca 141. Ndërfaqe ASCAL AMS</i> <i>Evidenca 143. Ndërfaqe WEB UMT</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të	GVJ konstatoi përfshirjen e studentëve në procese akademike me pjesëmarrje në NJSBC, në GVB, gjë e cila garanton dëgjimin e zërit të studentëve në vendimmarrje. Njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet senatorëve, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndërkohë zyra e NJSBC-së përpunon të dhënat e pyetësorëve. Ky feedback i jep mundësi

përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	reflektimi pedagog të lëndës për problematika që mund të hasen, por edhe më gjerë pasi Përgjegjësi i Departamentit mund të kalojë për diskutim në mbledhje departamenti problematikat e ngritura duke marrë vendime përkatëse në hartim, rishikim dhe përmirësim programi. <u>GVJ sygjeron që shpërndarja e pyetësorëve të bëhet tek të gjitha programet e studimit dhe të sigurohet pjesëmarrje masive e studentëve</u> Evidenca: <i>Evidenca 5. Rregullore e FSHMT</i> <i>Evidenca 11. Praktikë për miratimin e planeve mësimore</i> <i>Evidenca 27. Pyetësi i studentëve FSHMT</i> <i>Evidenca 28. Rezultatet e pyetësorit studentët</i> <i>Evidenca 60. Pyetësor mbi mundësinë e zhvillimit të provimeve online gjatë pandemisë Covid 19</i> <i>Evidenca 62. Pyetësor mbi përdorimin e pajisjeve teknologjike nga studentët për mësimin online.</i> <i>Evidenca 67. Shembull Pyetësor vlerësimit studentëve për lëndët e programit të studimit</i> <i>Evidenca 124. Lista e aktiviteteve këshilli studentor UMT</i> <i>Evidenca 130. Politika dhe praktika për fitimin e bursave të studentëve</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në rregulloren e programit të studimit dhe të departamentit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB, si edhe në rregulloren e programit “Master Shkencor në Infermieri të Përgjithshme”. Në takim me GVJ, studentët shprehen pozitivisht me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është pozitive. Evidenca: <i>Evidenca 5. Rregullore e FSHMT</i> <i>Evidenca 21. Rregullore FSHMT MSH</i> <i>Evidenca 31. Procedura e provimeve</i> <i>Evidenca 61. Procedurë ankimimi i studentit për vlerësimin</i>

	<i>Evidenca 92. Syllabusët MSH</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e UMT dhe rregulloret e UMT, Rregulloret e FSHMT, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të FSHMT.</i> <i>Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura, por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB.</i> <i>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Sekretaria mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, Zyra e këshillimit të Karrierës dhe Alumni, së bashku përbëjnë një njësi të vecantë në shërbim të studentëve. GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës funksionon në bazë të rregullores së miratuar së miratuar nga Senati akademik. Kjo zyrë realizon informimin e studentëve që nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. Studentët gjithashtu informohen edhe nga faqja e ëebit e cila përditësohet vazhdimisht. <i>GVJ sygjeron që punonjësit e këtij zyre të përpiqen të informojnë më shumë studentët rreth shërbimeve që ofrojnë.</i> Evidenca <i>Evidenca 1. Statuti UMT</i> <i>Evidenca 3. Organigrama UMT</i>

	<i>Evidenca 69. Përbërja e NJSBC</i> <i>Evidenca 107. Manuali i këshillimit të karrierës FSHMT</i> <i>Evidenca 109. Analizë vjetore sekretaria mësimore</i> <i>Evidenca 180. Rregullore e funksionimit të NJSBC-UMT</i> <i>(Takimi me stafin e zyrës Këshillimit të Karrierës, Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në takimin që GVJ zhvilloi me studentët, konstatoi se ata ishin të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese, bashkë me pedagogët. Njësia përgjegjëse për këtë program studimi administron rrjetet sociale për të krijuar një kontakt më të afërt dhe miqësor me studentët, duke ofruar në këtë mënyrë informacion dhe këshilla që lidhen me programin e studimit. <i>(takimi me studentët)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në UMT Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni është përgjegjëse për ndërtimin e marrëdhënieve midis studentëve në breza të ndryshëm. Nga takimi i GVJ me studentët u konstatua se për pjesën më të madhe të tyre, Zyra e informimit dhe këshillimit të karrierës funksiononte në mënyrë të vazhdueshme duke mbajtur leksione të hapura, trajnime dhe duke përfshirë studentët në panairët e punës. Por kishte edhe studentë që nuk kishin informacion për këtë zyrë. Shumica e tyre referuan se ishin të kënaqur nga zyra e këshillimit të karrierës. Kjo zyrë i ndihmon ata për: - Identifikimin e burimeve për pozicione të vecanta pune; - Udhëheqje akademike; - Identifikimin e shprehive dhe aftësive; Evidenca: <i>Evidenca 39. Njoftim për thirrje mobiliteti</i> <i>Evidenca 107. Manuali i këshillimit të karrierës FSHMT</i> <i>Evidenca 108.1 Aktiviteti i Zyrës së Karrierës</i> <i>Evidenca 108 Aktiviteti i Zyrës së Karrierës FSHMT</i> <i>Evidenca 166. Lista e mobiliteteve hyrëse dhe dalëse, analizë statistikore</i>

	<i>Takimi me studentët</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konstatoi nga dokumentacionet e shqyrtuara se Zyra e Këshillimit të Karrierës realizonin aktiviteti si: Këshillim individual i karrierës, Organizimi i tryezave të rrumbullakta, seminare, konferenca, panaireset e punës, etj. Në këtë formë UMT dhe FSHMT ndjekin studentët pas diplomimit dhe monitoron shkallën e punësimit. Evidenca: <i>Evidenca 107. Manuali i këshillimit të karrierës FSHMT</i> <i>Evidenca 108.1 Aktiviteti i Zyrës së Karrierës</i> <i>Evidenca 108 Aktiviteti i Zyrës së Karrierës FSHMT</i>			
Konkluzione	<i>UMT ka procedura dhe njësi të posacme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë struktura të posacme si (Drejtoria e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, Sekretaria mësimore, Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e IT).</i> <i>Institucioni ka vënë në shërbim të studentëve Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe realizon informimin e studenteve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim.</i> <i>Zyra e Këshillimit të Karrierës asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data-bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, UMT ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Pas takimeve që GVJ zhvilloi me drejtuesit e institucionit, me studentët, me stafin, NJSBC, dhe bazuar edhe në të gjitha referencat e vëna në dispozicion, konkludon se Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, nëpërmjet NJSBCS-së bën të mundur zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC, funksionon plotësisht në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit dhe veprimtaria kwsaj strukture bazohet dhe zbatohet sipas një rregulloreje të miratuar institucionale. NJSBC organizon, së bashku me ekspertë të jashtëm, trajnime për stafin e departamentit, duke nxitur përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. NJSBC vlerëson në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike funksionalitetin, efikasitetin dhe produktivitetin e stafit të FSHMT në lidhje me veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore nëpërmjet pyetësorëve anonim dy herë në vit që ju bëhen studentëve mbi aktivitetin mësimor, aktivitetin shkencor, infrastrukturën e institucionit, komunikimin me sekretarinë, administratën etj. Evidenca : <i>Evidenca 1. Statuti i UMT</i> <i>Evidenca 2. Rregullore e UMT</i> <i>Evidenca 170. Plani strategjik i Zhvillimit të UMT 2021-2024</i> <i>Evidenca 180. Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit	KPSSC është struktura përgjegjëse në UMT që monitoron përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, së bashku me NJSBC-në, në bashkëpunim edhe me Departamentin. Pas shqyrtimit të RVB dhe vizitës së zhvilluar në institucion, GVJ konstatoi se NJSBC në UMT bazuar edhe në rregulloren e kësaj njësie ka si synim të përmirësojë rezultatet dhe rritjen e pritshmërive në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Përmirësimi i cilësisë



akademik dhe ndihmësakademik.	realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Mekanizmat kryesorë që përdoren janë: Pyetësi i studentëve; Formular i performancës akademike; Rezultatet i vihen në dispozicion departamentit, dekanit, rektorit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë, por edhe vënia në pah e sygjërimeve të studentëve. Evidenca: <i>Evidenca 27. Pyetësi i studentëve FSHMT</i> <i>Evidenca 28. Rezultatet e pyetësit të studentëve</i> <i>Evidenca 67. Shembull pyetësor -Vlerësimi i studentëve për lëndët e programit të studimit, formular</i> <i>Evidenca 68. Shembull pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular</i> <i>Evidenca 155. Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ</i> <i>Evidenca 156. Shembull Vlerësimi i performancës së stafit akademik</i> <i>Evidenca 180. Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Përfshirja e studentëve në UMT në NJSBC, GVB dhe Senat akademik, u jep atyre mundësinë për të qenë një zë i fuqishëm si përfaqësim, por edhe të japin mendimet e tyre lidhur me vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve dhe trajtimin e ankimeve. Në rregulloren e UMT shprehet qartësisht përfshirja e studentëve në vlerësimin e stafit akademik dhe joakademik, nëpërmjet pyetësorëve të shpërndarë nga NJSBC. Studentët duke qenë të angazhuar edhe në Këshillat Studentorë, u jepet mundësia e krijimit të lidhjeve të ngushta me Departamentin por edhe me Fakultetin. Kjo lidhje i bën ata kontributorë të rëndësishëm në cilësinë e programit të studimit. Gjithashtu UMT u jep mundësinë studentëve që nëpërmjet ankimimeve/peticioneve në site online të shprehen lidhur me sygjërimet apo pakënaqësitë e tyre. Evidenca: <i>Evidenca 27. Pyetësi i studentëve FSHMT 2023</i> <i>Evidenca 28. Rezultatet e pyetësit të studentëve 2023</i>

	<i>Evidenca 60. Pyetësor mbi mundësinë e zhvillimit të provimeve online gjatë pandemisë Covid 19</i> <i>Evidenca 61. Procedurë ankimimi studenti për vlerësim</i> <i>Evidenca 67. Shembull Pyetësor Vlerësimi i studentëve për lëndët e programit të studimit formular</i> <i>Evidenca 68. Shembull pyetësor vlerësim i studentëve për UMT formular</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në UMT dhe FSHMT për të siguruar përmirësimin e cilësisë përdoren dy mekanizma të rëndësishëm; Pyetësori i studentëve dhe Formulari i performancës akademike. Vlerësimi i performancës akademike bazohet në tre drejtime kryesore; mësimdhënie, kërkim shkencor dhe aktivitete administrativ. Drejtuesi i Departamentit është ai që plotëson performancën për secilin nga anëtarët e departamentit bazuar në raportimet e këtij të fundit, ku më pas ato depozitohen në dosjet e secilit anëtar. Ndërkohë sa i përket pyetësorëve të studentëve, NJSBC, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore, shpërndan pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit. Institucioni harton raportin në fund të çdo viti akademik i cili publikohet në faqen zyrtare të Universitetit, me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë nga institucioni. Evidenca: <i>Evidenca 14. Shembull formulari i performancës 2023</i> <i>Evidenca 27. Pyetësori i studentëve FSHMT 2023</i> <i>Evidenca 28. Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023</i> <i>Evidenca 83, 84, 85. Raporti vjetor DLKIPISBP</i> <i>Evidenca 109. Analizë vjetore sekretaria mësimore</i> <i>Evidenca 153.1. Raportim i aktivitetit shkencor personel akademik 20-23</i> <i>Evidenca 154. Analizë për aktivitetin kërkimorshkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Gjatë vizitës që GVJ zhvilloi në institucion, si në takimin me autoritetet drejtuese ashtu edhe me stafin akademik konstatoi gadishmërinë e mbështetjes për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesëmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështetja financiare për të botuar artikuj në revista me faktor të lartë impakti, monografi dhe botime të ngjashme shkencore). Evidenca:

	<i>Evidenca 153.1. Raportim i aktivitetit shkencor personel akademik 20-23</i> <i>Evidenca 154. Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT</i> <i>Takim me drejtuesin e Nësisë Kryesore, drejtuesin e Njesisë Bazë, stafin akademik.</i>			
Konkluzione	<i>UMT ka ngritur me eficencë të plotë një sistem të sigurimit të cilësisë npm të cilit monitoron e vlerëson përmes njësive specifike e në mënyrë periodike programet e studimit. Ky sektor në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore shpërndan pyetësorë tek studentët për matjen e performancës dhe cilësinë e mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Referuar nenit 3 të Ligjit për Arsimin e Lartë, UMT ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në statutin e UMT janë sanksionuar procedurat dhe politikat për të siguruar cilësinë e institucionit. Rol të rëndësishëm në veprimtaritë institucionale luajnë komisionet e ngritura në nivel institucional. Përvec këaj gjatë vizitës në institucion GVJ u informua lidhur me pyetësoni që realizohej tek studentët, i përbërë nga disa rubrika që lidheshin me mësimdhënien, korrektësinë e stafit akademik, programin që ata ndiqnin etj. Ky pyetësor menaxhohej nga NJSBC Evidenca: <i>Evidenca 1. Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë</i> <i>Evidenca 3. Organigrama UMT</i> <i>Evidenca 100. Rregullore për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet, Organet Drejtuese, Komisionet</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Që prej vitit 2017 në UMT funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila siguron zhvillimin e cilësisë së arsimit. Kjo strukturë bashkëpunon dhe me aktorë të jashtëm, duke i pasur dhe pjesë të grupit të punës. Kjo strukturë përbëhet nga 7 anëtarë ku njëri është student. Gjithashtu miratuar me VKM, UMT zbaton edhe Kodin e Cilësisë, i cili garanton cilësinë, e promovon atë në nivel institucional, cilësinë e mësimdhënies dhe cilësinë e programeve. Evidenca: <i>Evidenca 1. Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë</i>

	<i>Evidenca 5.Rregullore FSHMT</i> <i>Evidenca 69. Përbërja e NJSBC – VSA nr.103, dt.20.10.2020. Për miratimin e NJSBC në UMT</i> <i>Evidenca 170. Plan strategjik i Zhvillimit të UMT 2021-2024</i> <i>Evidenca 180. Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Pas shqyrtimit të RVB-së, dhe vizitës 2 ditore në institucion, GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në FSHMT dhe UMT realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Ndërsa Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë sigurohet nëpërmjet: • Sondazheve me studentët; • Vlerësimit të performancës së stafit; • FSHMT është e përfshirë në Sondazhin Kombëtar të Studentëve SKS 2022, si edhe ka organizuar pyetësin e studentëve për vitin 2022-2023 për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies; Në përfundim të këtyre proceseve vlerësuese hartohen raportet përkatëse të cilat përfshihen në analizën vjetore të Departamentit dhe të Fakultetit. Evidenca: <i>Evidenca 1. Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë</i> <i>Evidenca 27. Pyetësi i studentëve FSHMT 2023</i> <i>Evidenca 28. Rezultatet e pyetësit të studentëve 2023</i> <i>Evidenca 79.1.Raporti Vjetor_UMT_2021-2022</i> <i>Evidenca 79.Raporti Vjetor_UMT_2020-2021</i> <i>Evidenca 80.Raport vjetor FSHMT 2020-2021.</i> <i>Evidenca 81.Raport vjetor FSHMT 2021-2022.</i> <i>Evidenca 82. Raport vjetor FSHMT 2023</i> <i>Evidenca 83. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2023</i> <i>Evidenca 84. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2022</i> <i>Evidenca 85. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2021</i> <i>Evidenca 169. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional UMT Maj 2022</i> <i>Evidenca 180. Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT</i>

Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ konstatoi se FSHMT me anë të kontrollit të cilësisë dhe raportimit të tyre, arrin të promovojë arritjet më të mira. Drejtuesi i <i>DLKIPISBP</i> në përfundim të vitit akademik vlerëson performancën e pedagogëve të këtij departamenti (mësimdhënia, aktiviteti shkencor dhe aktiviteti administrative), e më pas ato depozitohen në dekanat. Gjithashtu edhe NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues sasior dhe cilësor në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitur iu dërgohen të gjithë strukturave sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe në vecanti <i>DLKIPISBP</i> përgjegjëse për programin “Master i Shkencave në Infermieri”, merr vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarrëvajtjes së programit studimor. Evidenca: <i>Evidenca 14. Shembull formulari i performancës 2023</i> <i>Evidenca 83. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2023</i> <i>Evidenca 84. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2022</i> <i>Evidenca 85. Raporti vjetor DLKIPISBP viti akademik 2021</i> <i>Evidenca 155. Shembull vlerësimi i performancës së stafit administrativ</i> <i>Evidenca 156. Shembull vlerësimi i performancës së stafit akademik</i> <i>Evidenca 169. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional UMT Maj 2022</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UMT dhe në rregulloren e institucionit.</i> <i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit dhe funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitete bazuar në rregulloren NJSBC.</i> <u><i>GVJ rekomandon që NJSBC të zhvillojë fushata informuese tek studentët lidhur me rolin e saj dhe të jetë sa më pranë studentëve.</i></u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Programi i studimit Master i Shkencave në Infermieri ofrohet në nivel fakulteti, dhe për sigurimin e cilësisë së këtij programi bashkëpunojnë të gjitha strukturat. Raportet vjetore në nivel departamenti dhe fakulteti analizojnë ecurinë e programit në tërësi por duke përfshirë edhe plan masash për përmirësim. Të gjitha gjetjet e vlerësimit vjetor janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC. GVJ konstatoi se UMT kryen një vlerësim të brendshëm vjetor që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili gjithashtu dërgohet në MAS. <i>GVJ rekomandon përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani pune me adresim konkret të problematikave.</i> Evidenca <i>Evidenca 79; 79.1 Raporti Vjetor UMT</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT</i> <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga	Bazuar në informacionin që RVB paraqet, evidencave përkatëse dhe informacioneve që GVJ mori gjatë vizitës 2 ditore në institucion, rezulton se në mbledhjet e departamentit në fund të çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetëtorët e studentëve, pyetëtorët për stafin akademik dhe joakademik si dhe formularët e vetvlerësimit. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të FSHMT. Në fund bëhet një analizë mbi gjetjet dhe shprehen mundësitë e përmirësimit dhe rekomandohen plan masat. Ndërkohë që në nivel universiteti NJSBC përgatit raportin vjetor, raport ky i cili

personeli akademik dhe studentët.	më pas diskutohet në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit. Evidenca: <i>Evidenca 5. Rregullore FSHMT</i> <i>Evidenca 76. Plan veprimi 2021-2023 për Rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë</i> <i>Evidenca 79; 79.1 Raporti Vjetor UMT</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT</i> <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstatoi se institucioni përdor mekanizma dhe metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë dhe mbarëvajtjen e programit. Proceset vlerësuese të studentëve por edhe diskutimet e hapura të stafit akademik me studentët në lidhje me procesin mësimor, cilësinë e mësimdhënies, të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimeve të provimeve apo detyrave të kurseve, etj, janë metoda të drejtpërdrejta që FSHMT përdor të sigurar vlerësimin e cilësisë. Kërkesat e studentëve por edhe të tregut të punës merren në konsideratë për përditësimin e kurrikulave, me iniciativën e departamentit, deri në masën 20%. Evidenca: <i>Evidenca 27. Pyetësori i studentëve FSHMT</i> <i>Evidenca 28. Rezultatet e pyetësorit të studentëve</i> <i>Evidenca 180. Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik.</i> <i>Takim me studentët</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta	FSHMT, në kuadër të vlerësimit të cilësisë për programin e studimit Master Shkencor në Infermeri përdor mekanizmat e mëposhtëm kryesorë: - Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve; - Sistemi i Tutorëve/senatorëve të Grupeve të studentëve;

vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	- Raportet e stafit akademik gjatë vitit shkollor dhe Informacioni nga UISH në lidhje me rezultatet në provimin e licencës; Ndërkohë zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar në këtë fakultet duke i bërë pjesë edhe në organizime të ndryshme. Evidenca: <i>Evidenca 27. Pyetësori i studentëve FSHMT</i> <i>Evidenca 28. Rezultatet e pyetësorit të studentëve</i> <i>Evidenca 60. Pyetësor mbi mundësinë e zhvillimit të provimeve online gjatë pandemisë Covid 19</i> <i>Evidenca 62. Pyetësor mbi përdorimin pajisjeve teknologjike nga studentët për mësimin online</i> <i>Evidenca 67. Shembull pyetësor Vlerësimi i studentëve për lëndët e programit të studimit, formular</i> <i>Evidenca 107. Manuali i këshillimit të karrierës FSHMT</i> <i>Evidenca 108.1 Aktiviteti i zyrës së karrierës</i>			
Konkluzione	<i>FSHMT përdor mekanizma e procedura të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit.</i> <i>Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetësorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti, vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik.</i> <i>Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezultatet e proceseve të anketimit të studentëve paraqiten në Raportin vjetor të institucionit.</i> <i>Një formë tjetër janë edhe rezultatet mjaft pozitive në provimin e licencimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstatoi se në përbërje të NJSBC janë 7 anëtarë, ndërmjet të cilëve një ekspert të jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve. Në këtë mënyrë garantohet se politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshijnë aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Struktura më aktive në këtë proces është NJSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe vecanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e cilësisë së UMT, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Strukturat e sigurimit të cilësisë kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Studentët janë të përfaqësuar në Senat, në NJSBC, si dhe në hartimin e RVB për vlerësim të jashtëm pranë ASCAL. Evidenca: <i>Evidenca 2. Rregullore e Universitetit të Mjekësisë Tiranë</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e FSHMT</i> <i>Evidenca 21. Rregullore FSHMT program cikli i dytë Maste Shkencor</i> <i>Evidenca 69. Përbërja e NJSBC – VSA nr.103, dt.20.10.2020. Për miratimin e NJSBC në UMT</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rregullorja e programit si edhe rregullorja e UMT dhe FSHMT, përcaktohen qartësisht detyrat konkrete që kanë si njësitë ashtu edhe stafi lidhur me sigurimin e cilësisë. Në takimin e realizuar me stafin dhe studentët, GVJ u informua se studentët përfshihen në vlerësimin periodik institucional përmes anketimit edhe pse këto të fundit duhej të përfshinin edhe më shumë studentë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit, është konceptuar si përgjegjësi dhe angazhim lidhur me: - Harmonizimin e veprimtarisë të të gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë e programit të studimit; - Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë e programit të studimit;

	- Përcaktimin e parimeve, standardeve dhe procedurave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkëpunues dhe të koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit, dhe ndryshe sa jemi mësuar të dëgjojmë ditët e sotme, ata shprehën dëshirë për të kontribuar në Shqipëri dhe jo të largohen prej vendit tonë. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetësorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB. Evidenca: <i>Evidenca 2. Rregullore e Universitetit të Mjekësisë Tiranë</i> <i>Evidenca 5. Rregullore e FSHMT</i> <i>Evidenca 6. Rregullore Departamenti</i> <i>Evidenca 21. Rregullore FSHMT program cikli i dytë Master Shkencor</i> <i>Evidenca 27. Pyetësi i studentëve FSHMT 2023</i> <i>Evidenca 28. Rezultatet e pyetësorit të studentëve</i> <i>Evidenca 69. Përbërja e NJSBC – VSA nr.103, dt.20.10.2020. Për miratimin e NJSBC në UMT</i> <i>Evidenca 76. Plan veprimi 2021-2023 për rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Njësia bazë, si hallka më e rëndësishme, ku diskutohet rreth nevojave për ndryshime apo për përmirësim në programet e studimit organizon takime të vazhdueshme dhe përfshin të gjithë stafin akademik dhe joakademik në aktivitetin dhe veprimtarinë e NJSBC-së. Kjo gjë konfirmohet edhe nga takimet që GVJ pati me drejtuesin e njësive kryesore, drejtuesin e njësive bazë, me stafin akademik si edhe me studentët. Pikërisht kjo politikë ka krijuar një frymë përgjegjshmërie lidhur me rolin e secilit në ecurinë pozitive të programit të studimit. GVJ konstatoi se në përbërje të NJSBC përfaqësues të njësive kryesore, njësive bazë, anëtarë të personelit akademik dhe përfaqësuesin e studentëve. Evidenca: <i>Evidenca 79; 79.1 Raporti Vjetor UMT</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT</i> <i>Evidenca 83; 84; 85 Raporti vjetor DLKIPISBP</i>

	<i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	UMT me hartimin e Kodit të Etikës, bashkëpunimin me KPSSC dhe NJSBC është angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të të gjithë palëve në këtë proces vlerësimi. Përzgjedhja e aktorëve të brendshëm në proceset periodike të vlerësimit bëhet nga personeli akademik ku merren parasysh disa kritere të përfshirjes si, performanca akademike, integriteti, kompetencat profesionale; mundësitë për grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij me qëllim realizimin e vlerësimeve të ndryshme. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetësi, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve. Evidenca: <i>Evidenca 1. Statuti i Universitetit të Mjekësisë</i> <i>Evidenca 72. Kodi i Etikës UMT 2022</i> <i>Evidenca 116. Projekti i Qendrës së Biostimulimit klinik dhe Edukimit në vazhdim UMT</i> <i>Evidenca 146. Shërbimi i telemjekësisë</i> <i>Evidenca 182. Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Botimeve UMT, VSA nr.42 datë 29.04.2022</i> <i>Evidenca 183. Udhëzues për plotësimin e mobilitetit për stafin akademik</i> <i>Evidenca 184. Udhëzues për plotësimin e mobilitetit për studentët</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e	NJCBC ka në bazë të funksionimit të saj legjisllacionin në fuqi si edhe rregulloret e brendshme të UMT dhe Statutit të UMT, dhe qëllimi i kësaj strukture është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. Përveç vlerësimit të brendshëm periodik, të programit, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe prania e ekspertit të jashtëm si konsulent, po ashtu dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL dhe shërben për sigurimin e cilësisë, në lidhje me programin e studimit. GVJ konstatoi se detyrat dhe roli i anëtarëve të NJSBC përcaktohen në rregulloren e funksionimit

programit dhe përmirësimin e saj.	të NJSBC. Në përbërje të NJSBC është edhe një ekspert i jashtëm. Studentët e UMT dhe FSHMT të cilët kanë përfunduar studimet dhe punojnë e jetojnë jashtë shërbejnë si një konsulencë e jashtme dhe ekspertizë në lidhje me cilësinë e programit por edhe për përmirësimin e tij. Për një vlerësim më objektiv të programit të studimit dhe gjetjen e instrumentave më të mirë për përmirësim dhe përshtatje me tregun e punës, NJSBC organizon takime në nivel institucional e deri në nivel programi me pale të interesuara si punëdhënës të tregut publik apo privat dhe studentë alumni.			
Konkluzione	<i>UMT ka ngritur struktura dhe ka hartuar procedura dhe politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Aktet rregullatore lidhur me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të UMT përcaktojnë qartë strukturat dhe njësisë që angazhohen në këtë proces.</i> <i>Prania e përfaqësuesit të studentëve si anëtar të komisionit krijon mundësinë e bashkëveprimit me studentët për të bërë sa më efektiv kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i> <i>Gjithashtu edhe përfaqësuesi i ekspertit të jashtëm ndikon në përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë	GVJ konstatoi se aktiviteti, programi, rregullore të ndryshme të funksionimit të FSHMT, UMT janë të aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët. Cdo lloj informacioni në lidhje me politikat dhe praktikën që lidhen me sigurimin e Cilësisë në FSHMT, UMT janë lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë. Këto të dhëna janë transparente dhe

transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	publike për të gjithë palët e interesuara. Këto shfaqen në faqen zyrtare ëeb të UMT dhe FSHMT. Evidenca <i>Evidenca 143. Ndërfaqe Eëb UMT</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej FSHMT konstaton se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. FSHMT ka miratuar rregullore të funksionimit të prgrameve si dhe për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e tyre. Në faqen web publikohen të gjitha politikat dhe praktikat e sigurimit të cilësisë, të cilat janë të aksesueshme për të gjithë. Në takim me drejtuesen e Njesisë Kryesore si edhe me drejtuesin e Njesisë Bazë, GVJ u informua se, NJSBC kryhen në mënyrë periodike shpërndarjen e pyetësorëve për të cilët është punuar edhe menduar që të jenë të personalizuar dhe të detajuar për secilën lëndë, modul dhe me emër mbiemër të lektorit përkatës. Ato shpërndahen në mënyrë elektronike dhe janë tërësisht anonime. Informacioni i mbledhur i vihet në dispozicion drejtuesve të njësive bazë. Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm në faqen zyrtare ëeb për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar. Evidenca : <i>Evidenca 143. Ndërfaqe Eëb UMT</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili i përcillet senatit akademik, ndërsa publikohet edhe një përmbledhje e tij. Gjithashtu ky raport është i shoqëruar edhe me planin e masave për të përmirësuar edhe mangësitë e evidentuara. Evidenca: <i>Evidenca 76. Plan veprimi 2021-2023 për Rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë</i> <i>Evidenca 80; 81; 82 Raport vjetor FSHMT</i> <i>Evidenca 180. Rregullore e funksionimit të NjSBC-UMT</i>



Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit, NJSBC punon për përmirësimin e instrumentave të përdorur për vlerësim si dhe gjetjen e instrumentave të tjerë vlerësues. Në kuadër të gjetjes së këtyre mekanizmave organizohen takime të ndryshme nga NJSBC dhe përfaqësuesi i FSHMT, me studentët apo edhe me struktura të tjera të FSHMT.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Ndërsa nga ana e vetë institucionit, monitorimi, kontrolli dhe auditimi dhe raportimi është i vazhdueshëm. Studenti është në qendër të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit. NJSBC informon studentët në takime individuale apo të organizuara për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e programit të studimit. Në takimin me grupin e studentëve GVJ evidentoi që jo të gjithë e kishin plotësuar pyetësorin, gjë për të cilën, <u>GVJ rekomandon marrjen e masave për të përfshirë të gjithë studentët në plotësimin e pyetësorëve</u>. Gjithashtu në takim studentët patëm edhe propozime konkrete (shtimi i orëve të praktikës). Evidenca: <i>Evidenca 19. Aktiviteti dt.14 Nëntor 2023 në FSHMT</i> <i>Evidenca 76. Plan veprimi 2021-2023 për Rritjen e cilësisë së Arsimit të lartë</i> <i>Evidenca 149. Përshkrimi i funksionaliteteve të sistemit Pitagora</i> <i>Takimi me studentet</i> <i>Takimi me drejtuesin e Njesisë Kryesore, me drejtuesin e Njesisë Bazë</i>			
Konkluzione	<i>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit.</i> <i>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, raportohen në dekanatin e FSHMT lidhur me pikat e forta dhe dobësite e tyre. GVJ thekson se raportimet e kryera janë raporte përshkruese dhe analitike. Këto raporte shoqërohen me plane masash apo adresim problematikash të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Infermieri”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Master i Shkencave në “Infermieri” është hartuar duke u mbështetur në misionin, objektivat, strategjinë e zhvillimit të Universitetit të Mjekësisë në fushën e infermierisë dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike plotëson kriteret për personel akademik të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Infermieri”;
3. Infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor për programin e studimit plotëson standartet dhe kriteret e cilësisë;
4. Ngritja e strukturave për sigurimin e cilësisë në nivel departamenti që bashkëpunojnë me NJSBC është pjesë e planit strategjik të Institucionit për të përmbushur misionin e tij;
5. Universiteti Mjekësisë ka marrëdhënie bashkëpunimi me një sërë Institucione të tjera, si spitale shtetërore dhe klinika private, të cilat i mundësojnë Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamentet të realizojë praktikat profesionale të parashikuara për programin e studimit Master i Shkencave në “Infermieri”;

b. Pika të dobëta:

1. Mospërputhja për disa kategori të veprimtarive formuese të programit të studimit, me ngarkesën respektive në kredite të përcaktuar sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018; (*Standarti II.1, kriteri 1, konkluzione*)
2. Shumica e syllabuseve nuk i përmbanin të gjithë elementët në përputhshmëri me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; (*Standarti II.3, kriteri 4*)
3. Literatura bazë dhe e rekomanduar e përdorur, jo gjithmonë është e përditësuar në edicione të viteve të fundit; (*Standarti II.4, kriteri 5; Standarti IV.3, kriteri 1*)

4. Mosrealizim i ngarkesës mësimore për këtë program studimi në masën 70% nga stafi akademik efektiv, në ndryshim nga parashikimet e akteve nënligjore në fuqi që i referohen realizimit të kesaj ngarkese mësimore; (*Standarti IV.1, kriteri 2*)

Rekomandime

1. GVJ rekomandon rregullimin e shpërndarjes së veprimtarive të planit mësimor sipas VKM 41, 2018;
2. GVJ rekomandon që të rishikohen syllabuset në përputhshmëri me VKM 41, 2018, dhe të përditësohet literatura;
3. GVJ rekomandon që në përmirësimet e programit të studimit të përfshihen studentët dhe aktorët e tjerë;
4. GVJ rekomandon që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës mësimore midis PAE dhe PAK në këtë program studimi në mënyrë që mbulimi i ngarkesës nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të përputhet tërësisht me standartet e kërkuara që i referohen mbulimit të ngarkesës mësimore në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi (në masën 70%);
5. GVJ rekomandon që të gjenden mundësi më të mira për pjesëmarrjen e studentëve në plotësimet e pyetësoreve;
6. GVJ sugjeron se orët laboratorike mund të ulen dhe të rriten orët e praktikës;

Conclusions of the Evaluation of the second cycle Master of Science in "Nursing"

a. Strengths and Affirmations:

1. The Master of Science in "Nursing" study program was designed based on the mission, objectives, development strategy of the University of Medicine in the field of nursing and in accordance with the legal and by-laws in force;
2. The Faculty of Technical Medical Sciences fulfills the criteria for academic personnel engaged in the Master of Science in "Nursing" study program;
3. The infrastructure that is available for the development of the learning process for the study program meets the quality standards and criteria;
4. The establishment of quality assurance structures at the departmental level that cooperate with Internal Quality Assurance Unit is part of the Institution's strategic plan to fulfill its mission;



5. The University of Medicine has cooperative relations with a number of other Institutions, such as state hospitals, which enable the Faculty of Technical Medical Sciences and Departments to carry out the professional practices provided for the Master of Science in "Nursing" study program;

b. Weak points:

1. Some categories of formative activities of the study program are not in compliance with the respective credit load determined according to VKM no. 41, dated 01/24/2018; (*Standard II.1, Criterion 1*)
2. The majority of the syllabi did not encompass all the elements in accordance with VKM No. 41, dated 01/24/2018; (*Standard II.3, criterion 4*)
3. It is notable that the fundamental and recommended literature is not always updated in recent editions, which is a shortcoming that should be addressed; (*Standard II.4, criterion 5; Standard IV.3, criterion 1*)
4. The teaching load for this study program has not been fulfilled by the effective academic staff to the extent of 70%, in contravention of the provisions set out in the bylaws that refer to the realization of this teaching load; (*Standard IV.1, criterion 2*)

Recommendations

1. The external evaluation group has recommended that the distribution of curriculum activities be adjusted in accordance with the provisions set forth in VKM 41, 2018;
2. The external evaluation group recommends that the syllabuses be revised in accordance with the standards set forth in VKM 41, 2018, and that the literature be updated accordingly;
3. The external evaluation suggests that students and other relevant stakeholders be included in the process of improving the study program;
4. The external evaluation group recommends that the distribution of the teaching load between full-time and part-time academic personnel in this study program be revised so that the load is covered by the full-time academic personnel engaged in the teaching process. This is to ensure compliance with the legal framework in force, which requires that teaching loads be covered to the extent of 70%;
5. The external evaluation group suggests that more opportunities be provided for students to complete questionnaires;
6. The external evaluation group has proposed that the number of hours dedicated to professional practice should be increased;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X